




ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM  
KANCELARIJA GENERALNOG REVIZORA  
OFFICE OF THE AUDITOR GENERAL

A decorative graphic consisting of multiple thin, overlapping wavy lines in a light beige or gold color, creating a sense of movement and depth on the left side of the page.

---

**RAPORTI VJETOR I AUDITIMIT  
GODIŠNJI IZVEŠTAJ REVIZIJE  
ANNUAL AUDIT REPORT  
2013**

---



## TABELA E PËRMBAJTJES

Fjala e Auditorit të Përgjithshëm .....	5
1. Hyrje .....	7
2. Auditimi i jashtëm dhe llogaridhënia.....	8
3. Raporti Vjetor Financiar për Buxhetin e Kosovës dhe Llogaridhënia e Qeverisë10	
3.1 Hyrja dhe Qasja e auditimit.....	10
3.2 Opinioni i Auditimit për Pasqyrat e Konsoliduara Financiare 2013.....	11
3.3 Pasqyrat vjetore financiare të Buxhetit të Kosovës për 2013 .....	11
3.4 Analiza e PVF/BK për vitin 2013.....	14
3.5 Shpalosja e pasurive jo financiare dhe detyrimet e papaguara.....	20
3.6 Adresimi i rekomandimeve të dhëna në vitin 2012.....	22
3.7 Rekomandimet e përgjithshme .....	24
4. Menaxhimi Financiar Publik .....	25
4.1 Planifikimi i buxhetit.....	25
4.3 Reformat në Shërbimin Civil dhe kompensimet .....	30
4.4 Prokurimi publik.....	32
4.5 Rekomandimet e përgjithshme .....	33
5. Ekzekutimi i buxhetit në Sektorin Publik .....	34
5.1 Autoritetet qendrore .....	34
5.2 Institucionet e pavarura.....	38
5.3 Komunitat.....	40
5.4 Ndërmarrjet Publike dhe Shoqërore.....	44
5.5 Privatizimi.....	48
5.6 Partneritetet Publiko Private .....	49
Shtojca I: Llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga Auditori i Përgjithshëm.....	51
Shtojca II. Opinionet e auditimit dhe mangësitë kryesore menaxheriale.....	53



## FJALA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM



Të nderuar anëtarë të Kuvendit,

Fillimisht më lejoni të shpreh urimet e mija për të gjithë ju deputetët e Legjislaturës së pestë. Kam kënaqësinë e madhe që t'ju dorëzoj Raportin Vjetor të Auditimit të këtij viti, i cili shpresoj të jetë i vlefshëm për ambiciet e juaja për ti shërbyer qytetarëve të Kosovës.

Ky raport mbulon zbatimin që Qeveria i ka bërë buxhetit 2012 dhe Pasqyrave Vjetore Financiare të Buxhetit të Kosovës për atë periudhë. Ne vazhdimisht i jemi adresuar misionit tonë themelor për ofrimin e bazës që shërben për të kërkuar llogari nga menaxherët shpenzues të parasë publike dhe për dhënien e kontributit për përmirësime në fushën e Menaxhimit të Financave Publike.

Unë jam auditori i të gjitha entiteteve publike, me vetëm një numër të vogël përjashtimesh. Ne auditojmë çdo gjë në lidhje me Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës deri tek entitetet më të vogla, si dhe disa fonde të donatorëve.

Prandaj, puna e përditshme në zyrë na ofron një pikëpamje më të gjerë e të detajuar mbi aktivitetet në sektorin publik. Një auditor i mirë e kupton punën e entitetit dhe pasqyrat e tij. Procesi i dhënies së një opinionit auditimi mbi pasqyrat financiare përfshin gjithashtu formimin e një pikëpamje mbi anët e forta

e të dobëta të qeverisjes dhe sistemeve menaxheriale të një organizate.

Përveç punës për ofrimin e sigurisë për pasqyrat financiare, ligji jonë na mundëson kryerjen e auditimit të performancës përmes të cilit ne ekzaminojmë ekonomicitetin, efektivitetin dhe efikasitetin. Ligji gjithashtu na mundëson të kryejmë shërbime të tjera auditimi dhe të hetojmë çdo çështje tjetër që ka të bëjë me përdorimin e burimeve të një entiteti.

Në esencë, ne presim nga entitetet publike që të jetë të afta që, nga brenda, ti demonstrojnë Qeverisë dhe publikut se pyetjeve të mëposhtme mund tu jepen përgjigje pozitive:

- A janë duke i shpenzuar ata paratë publike me kujdes e në pajtim me pritshmëritë?
- A janë duke e menaxhuar si duhet procesin për shpenzimin e tij?
- A janë duke bërë ata gjënë e duhur?

Rrjedhimisht, ne po i artikulojmë gjashtë parimet bazë, të cilat janë relevante për auditimin e jashtëm dhe për mbikëqyrjen e mënyrës se si përdoren fondet publike.

**Llogaridhënia** – Entitetet publike duhet të japin llogari për performancën e tyre dhe të jenë në gjendje të japin pasqyra të plota dhe të sakta për mënyrën si i kanë shpenzuar fondet publike, përfshirë fondet që u janë dhënë të tjerëve për qëllime të veçanta. Ato duhet të kenë gjithashtu marrëveshje të përshtatshme qeverisëse dhe menaxheriale për të mbikëqyrur marrëveshjet për financim.

**Çiltërsia**– Entitetet publike duhet të jenë transparente në administrimin e fondeve, si për të mbështetur llogaridhënien ashtu edhe për të promovuar qartësi dhe të kuptuarin e përbashkët të roleve dhe detyrimeve përkatëse mes entiteteve dhe çdo pale të jashtme që hyn në marrëveshje financimi. Kjo duhet të mbështetet në marrëveshje të duhura për raportim.

**Vlera për para** – Entitetet publike duhet ti përdorin burimet në mënyrë efektive dhe ekonomike dhe pa humbje, me kujdesin e duhur për kostot dhe fitimet totale të një marrëveshje dhe kontributit të saj në rezultatet që entiteti mundohet ti arrijë.

**Ligjshmëria** – Entitetet publike duhet të vepronë në kuadër të ligjit dhe të përmbushin obligimet e tyre ligjore.

**Drejtësia** – Entitetet publike kanë të drejtën ligjore për të vepruar drejt dhe në mënyrë të arsyeshme ndaj publikut të gjerë. Ato duhet të jenë, dhe të tregojnë që janë, të paanshëm në vendimmarrjen tyre.

**Integriteti** – çdokush që menaxhon burimet publike duhet ta bëjë atë me integritetin më të lartë. Standardet që duhen zbatuar janë të qarta dhe entitetet publike duhet ta bëjnë të qartë se ato, që kur financojnë organizata të tjera, presin standarde të ngjashme prej tyre.

Ne kemi punuar ngushtë me Kuvendin dhe Qeverinë për ti zhvilluar më tej këto parime si një bazë për reformat aktuale në ndërtimin e qeverisjes së mirë dhe sistemeve më të mira për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin.

Cilësia e informacionit në Buxhetin e Kosovës dhe Pasqyrat Vjetore Financiare

është përmirësuar nga viti në vit. Megjithatë, tani përballemi me pritshmëri dhe kërkesa më të larta rreth saktësisë dhe vlefshmërisë së informacionit dhe statistikave.

Duke pasur parasysh situatën buxhetore, ne duhet të arrijmë më shumë me paratë që kemi. Prandaj Kosova duhet të fokusohet më shumë në maksimizimin e rezultateve të arritura dhe ta reflektojë atë në vendimmarrje dhe prioritetet politike. Zbatimi i mekanizmave dhe sistemeve të nevojshme për menaxhim financiar kërkon zotim dhe mbështetje nga të gjitha nivelet e larta. Edhe pse procesi i llogaridhënies është vonuar këtë vit, masat për të kërkuar llogari nga menaxherët përkatës duhet të ndërmerren. Më tutje, në rast të keqmenaxhimit dhe keqpërdorimit të fondeve publike duhet të ndërmerren veprime të palëkundshme.

Në situatën aktuale, ne do të fokusohemi më shumë në përcjelljen e mënyrës se si adresohen rekomandimet tona, dhe do të vazhdojmë të punojmë ngushtë në partneritet me menaxhmentet e të gjitha entiteteve për të nxitur përmirësime.

Ky raport paraqet sfidat kyçe që duhet të adresohen, të cilat në disa fusha reflektojnë sfida të rëndësishme. Unë e lëvdoj këtë raport para anëtarëve të nderuar dhe pres me padurim diskutimet dhe përgjigjet tuaja.



Prishtinë, Gusht 2014

## 1.Hyrje

Gjatë sezonit 2013/14, puna jonë e auditimit ka adresuar përsëri një gamë auditimesh statutore të rregullsisë dhe auditime jo statutore të performancës, menaxhimit dhe kontrolleve. Kjo rezultoi me paraqitjen e 102 raporteve të auditimit në Kuvend. Rekomandimet në to kanë ofruar këshilla të fokusuara dhe me prioritete në mbështetje të menaxhimit më të mirë financiar në administratën publike dhe përmirësimit të shërbimeve publike.

Në kontekstin e auditimit të rregullsisë, raportet finale të auditimit pasuan memot e ndërmjetme, të bazuara në pasqyrat 9-mujore financiare. Kjo dhe mbështetja konstruktive ndaj organizatave buxhetore (OB-ve) në fazën përfundimtare të auditimit kanë lejuar ndërmarrjen e hershme të veprimeve për adresimin e dobësive në kontrollet e brendshme dhe/ose cilësinë e shpalosjeve dhe informacionit financiar në pasqyra. Produktet tona të tjera të auditimit dhe mbështetja më e përgjithshme kanë për qëllim të ofrojnë mbështetje të ngjashme konstruktive sipas nevojës.

Ky raport përmbledh rezultatet e auditimeve tona për vitin 2013 dhe thekson çështjet kyçe dhe temat e përbashkëta që Qeveria, Kuvendi ose Kuvendet Komunale duhet ti trajtojnë në mënyrë aktive. Menaxhimi efektiv dhe zbatimi i rekomandimeve është një mekanizëm kyç me të cilin OB-të zhvillojnë aranzhimet e tyre qeverisëse dhe Qeveria dhe Kuvendet kanë një rol kyç në mbështetjen e këtij procesi.

Ky raport përfshin gjithashtu Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm në lidhje me Pasqyrat e Konsoliduara Vjetore Financiare të Buxhetit të Kosovës (PVF/BK). Ky auditim ka shqyrtuar rezultatet e auditimeve të OB-ve dhe ndikimin e tyre në Pasqyrat e Konsoliduara.

Raporti Vjetor i Auditimit për vitin 2012 u dorëzua në Kuvend në fund të gushtit, u shqyrtua në Komisionin për Mbikëqyrje të Financave Publike (KMFP) dhe u prezantua nga Auditori i Përgjithshëm në seancën plenare me 14 nëntor 2013. Edhe këtë vit pritet të ndiqet një proces i ngjashëm duke pasur parasysh veçanërisht faktin se KMFP-ja, për shkak të sidave në formimin e Kuvendit, nuk ka shqyrtuar ndonjë raport për OB-të këtë vit.

Për të mbështetur një rishikim efektiv të të gjeturave tona, ne e kemi organizuar raportin si në vijim:

- Kapitulli 2 – Auditimi i Jashtëm dhe Llogaridhënia
- Kapitulli 3 - Raporti Vjetor Financiar për Buxhetin e Kosovës dhe Llogaridhënia e Qeverisë
- Kapitulli 4 – Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
- Kapitulli 5 - Ekzekutimi i buxhetit në Sektorin Publik

Raporti ka edhe dy shtojca. E para shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të dhëna nga Auditori i Përgjithshëm në lidhje me auditimin e rregullsisë. E dyta përmbledh, në nivel të Organizatës Buxhetore, dobësitë menaxheriale / të gjeturat e rëndësishme të auditimit si dhe opinionet e dhëna dhe arsyet për opinionet e modifikuara. Raportet individuale të auditimit mund të gjenden në faqen tonë të internetit [www.oag-rks.org](http://www.oag-rks.org).

## 2. Auditimi i jashtëm dhe llogaridhënia

Publiku pret që ata të cilët janë të ngarkuar me menaxhimin e parasë publike të japin llogari për përdorimin e këtyre parave. Përgjegjësia kryesore për sigurimin se paratë publike trajtohen me integritet absolut dhe shpenzohen me maturi u takon Ministrave, deputetëve të zgjedhur të Kuvendit, organeve qeverisëse, menaxherëve dhe zyrtarëve. Auditimi në sektorin publik është një hallkë e rëndësishme e zinxhirit të llogaridhënies. Llogaridhënia duhet të forcohet, në drejtim të anëtarëve të zgjedhur të cilët alokojnë burimet, dhe nga jashtë në drejtim të konsumatorëve dhe përfituesve, tatimpaguesve dhe komunitetit më të gjerë në përgjithësi.

Auditimi i jashtëm shton vlerë jo vetëm duke analizuar dhe raportuar atë që ka ndodhur pas ngjarjes, por edhe duke shikuar në të ardhmen, përmes identifikimit të mësimeve që duhet mësuar si dhe duke përhapur praktika të mira. Auditimi i jashtëm i sektorit publik në këtë mënyrë ndihmon në promovimin e menaxhimit dhe vendim-marrjes më të mirë dhe si rrjedhojë përdorim më të efektshëm të burimeve të tatimpaguesve, dhe luan një rol të rëndësishëm në rregullimet e qeverisjes korporative të organeve publike. Transparenca dhe qasja publike në informacion është pjesë përbërëse e kësaj.

Auditimi i jashtëm në Sektorin Publik të Kosovës ofrohet nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP)<sup>1</sup> si Institucion Suprem i Auditimit (ISA). Roli i saj është të ndihmojë Kuvendin e Kosovës që të shqyrtojë efektivitetin, efikasitetin dhe llogaridhënien e entiteteve publike, të cilat janë përgjegjëse para tij. ZAP mbështet këtë proces të llogaridhënies përmes:

**Auditimit Financiar**, i cili vërteton nëse informacioni financiar në Pasqyrat Vjetore Financiare është i saktë dhe konsistent me raportimin financiar dhe kornizën rregullative dhe **Auditimit të pajtueshmërisë**, i cili konfirmon nëse proceset dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret relevante. Kjo qasje e kombinuar quhet **Auditim i Rregullsisë**; dhe

**Auditimit të Performancës**, i cili vërteton nëse projektet dhe programet ofrojnë ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitetet në përdorimin e burimeve. Auditimet e tjera të performancës, si ai menaxherial dhe të sistemit adresojnë aspekte të tjera të performancës; dhe

Raportet tona, duke përfshirë Raportin Vjetor të Auditimit, promovojnë llogaridhënien mes Kuvendit, Qeverisë dhe OB-ve, si dhe në nivel të OB-ve individuale. Raportet për OB-të ofrojnë bazë për llogaridhënie nga menaxherët përgjegjës për performancën e organizatës dhe sugjerojnë që të merren veprime për të adresuar dobësitë e identifikuar. Publikimi i të gjitha raporteve tona i lejon qytetarët që të kërkojnë llogari nga kujdestarët e burimeve publike.

---

<sup>1</sup> Auditimi statutor i Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), Fondit të Mirëbesimit, Radio Televizionit të Kosovës (RTK) dhe Agjencisë Kosovare të Inteligjencës (AKI) nuk kryhet nga Zyra jonë. Në rastin e Ndërmarrjeve Publike (NP) auditimi statutor mund të kryhet nga Zyra jonë.

Numri i raporteve të shqyrtuara nga KMFP ka treguar më herët rritjen e llogaridhënies në sektorin publik, një trend zhvillimi i cili u ndërpre këtë vit për shaka të sfidave në formimin e Kuvendit. Krahas kësaj, ne kemi ofruar këshilla për një varg çështjesh që mbështesin zhvillimet në Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MF/K), me theks të veçantë në:

- Zhvillimin e mëtejshëm të bashkëpunimit tonë me Kuvendin e ri dhe punën me komisione dhe jo vetëm me KMFP-në dhe në mbështetjen e debateve të informuara përmes ofrimit të informacionit relevant;
- Intervenimet me degën e ekzekutivit dhe projektet e ndryshme në kuadër të Menaxhimit të Financave Publike (MFP), duke përfshirë mbështetjen autoriteteve hetuese dhe të drejtësisë;
- Dhënien e mbështetjes së drejtpërdrejtë projektit të Kontrollit të Brendshëm të Financave Publike (KBFP) ku njëri nga Asistent Auditorët e Përgjithshëm është anëtar i Grupit Drejtues; dhe
- Dhënien e mbështetjes projekteve të tjera në fushën e MFP-së.

Rritja e llogaridhënies është gjithnjë e më e rëndësishme duke pasur parasysh sfidat me të cilat përballet integrimi në BE veçanërisht. Menaxherët duhet të demonstrojnë në mënyrë të qartë që ata i kuptojnë kërkesat në rritje të qeverisjes dhe iniciativat e lidhura me llogaridhënien të cilat duhet të zbatohen. Aktivitetet tona orientohen gjithnjë e më shumë në mbështetje të kësaj çështje së bashku me institucionet e tjera dhe zhvillimet e shumta të KBFP-së dhe MFP-së.

Megjithatë, janë zhvillimet e brendshme brenda secilit institucion ato të cilat do ti japin drejtim ndryshimit dhe zyrtarët përgjegjës duhet të vejnë theksin në:

- Menaxhimin dhe zbatimin e rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm në mënyrë aktive;
- Zhvillimin e mëtejshëm të auditimit të brendshëm për t'i ofruar menaxhmentit siguri efektive; dhe
- Plotësinë dhe efektivitetin e sistemeve të kontrollit të brendshëm krahas përdorimit më pro-aktiv të mjeteve të vetë-vlerësimit duke vepruar me kohë ndaj zbrazëtirave të identifikuara.

Duke pasur parasysh kufizimet buxhetore dhe rritjen e pritshmërive të qytetarëve dhe partnerëve ndërkombëtarë nga institucionet e sektorit publik, këto të fundit kanë përpara sfida të rëndësishme menaxheriale. Kjo kërkon më shumë fokusim në menaxhimin e rrezikut dhe sistemet e duhura që zbusin rreziqet. Ngjashëm me të, është e nevojshme që theksi të vihet në arritjen e vlerës më të mirë për para në përdorimin e burimeve të mangëta.

Përgjegjësitë e llogaridhënies për adresimin e këtyre kërkesave duhet të përcaktohen në mënyrë të qartë. Nëse kërkesat për ndryshim nuk adresohen në mënyrë aktive atëherë edhe përfitimi nga identifikimi i tyre do të jetë i kufizuar.

## 3. Raporti Vjetor Financiar për Buxhetin e Kosovës dhe Llogaridhënia e Qeverisë

### 3.1 Hyrja dhe Qasja e auditimit

PVF/BK përmbledhin transaksionet në lidhje me pothuajse të gjitha aktivitetet e Qeverisë<sup>2</sup>. Ministria e Financave (MF), në emër të Qeverisë, përgatit PVF/BK të vitit fiskal jo më larg se me 31 Mars të vitit pasues. Ato duhet të përgatiten sipas kornizës së përgjithshme të krijuar nga Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP) dhe sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik (SNKSP) për "Raportimin Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme".

Neni i 47.1 i LMFPP-së përcakton se ZAP është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e PVF/BK.

Auditimi ynë është fokusuar në:

- Pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, Pasqyrën e konsoliduar të krahasimit të buxhetit me ekzekutimin, dhe Pasqyrën e konsoliduar të pasurive në para të gatshme dhe bilancit të fondit;
- Nëse këto pasqyra financiare paraqesin, në të gjitha aspektet materiale, një pamje të drejtë dhe të vërtetë të gjendjes financiare për periudhën e auditimit; dhe
- Nëse janë ndërmarr masat e duhura nga Qeveria për implementimin e rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2012 dhe vitet e mëhershme.

Ekzaminimi i PVF/BK të për vitin 2013 u ndërmor në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtarisht të auditimit në Sektorin Publik (SNISA) të nxjerra nga INTOSAI<sup>3</sup>. Qasja jonë është bazuar në një kuptim të plotë të procesit nëpër të cilin PVF/BK janë hartuar. Ky kuptim na ka lejuar që të zhvillojmë një strategji auditimi, e cila përqendrohet në adresimin e rreziqeve specifike për një opinion të pakualifikuar ndërkohë që ofron një nivel të pranueshëm të sigurisë në pasqyrat financiare si tërësi.

Qasja e ndërmarrë është paraqitur në Memon e Planifikimit të Auditimit dorëzuar në MF më 31/03/2014 dhe reflekton një vlerësim të rezultateve të auditimeve të OB-ve të cilat janë konsoliduar në PVF/BK.

Procedurat tona kanë përfshirë një rishikim të kontrolleve të brendshme dhe sistemeve të kontabilitetit dhe procedurat vetëm deri në atë masë që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Si të tilla, të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive të cilat ekzistojnë, apo edhe të të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë funksionuar.

<sup>2</sup> Këtu nuk përfshihen aktivitetet e Bankës Qendrore, Fondit të Trustit të Pensioneve, dhe Agjencisë Kosovare të Inteligjencës.

<sup>3</sup> Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit.

## 3.2 Opinioni i Auditimit për Pasqyrat e Konsoliduara Financiare 2013

### **Opinion i pamodifikuar<sup>4</sup> me Theksim të çështjes**

“Pasqyrat Vjetore Financiare të Buxhetit të Republikës së Kosovës prezantojnë, në të gjitha aspektet materiale, një pamje të drejtë dhe të vërtetë të gjendjes financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2013”.

Si *Theksim i Çështjes* ne tërheqim vëmendjen tuaj tek prezantimi i pasaktë i pasurisë mbi 1,000€ (**ISSAI 200 Opinion i pamodifikuar me Theksim të çështjes**).

### **Baza për Theksim të çështjes**

Proceset joefektive për identifikimin e vlerave të pasurive në secilën OB dhe proceset jo të plota të konsolidimit të pasurive në kuadër të Ministrisë së Financave në lidhje me BK-në ka rezultuar me mos përfshirjen e vlerave materiale të pasurive në BK.

Informacioni për pasuritë kapitale të shpalosura në PVF/BK-së dhe në PVF individuale të OB-ve nuk janë konsistente. Në disa raste, OB-të kishin shpalosur gabimisht vlerën bruto e jo vlerën neto të pasurisë. Në disa komuna për shkak të kontesteve dhe paqartësisë së pronësisë, prona publike nuk ishte regjistruar në SIMFK duke pamundësuar shpalosjen e tyre në PVF/BK-së. Në PVF e BK-së ekziston një nën-vlerësim i pasurisë me 135,192,229€.

## 3.3 Pasqyrat vjetore financiare të Buxhetit të Kosovës për 2013

Rishikimi ynë i PVF/BK-së ka marrë parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të regjistruar në pasqyrat financiare. Ne gjithashtu kemi marrë parasysh deklaratën e bërë nga Ministri i Financave dhe Drejtori i Përgjithshëm i Thesarit kur draft PVF/BK-së iu dorëzuan Kuvendit dhe Auditorit të Përgjithshëm.

Deklarata në lidhje me prezantimin e PVF/BK përfshin një numër të pohimeve për sa i përket pajtueshmërisë me kornizën raportuese dhe cilësinë e informacionit në kuadër të pasqyrave financiare. Disa deklaratat kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

MF i ka dorëzuar PVF/BK Kuvendit dhe Auditorit të Përgjithshëm në afatin ligjor, me 31 mars 2014. PVF/BK kanë përmbushur të gjitha kërkesat e SNKSP “Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të Parasë së Gatshme”. Megjithatë, siç pasqyrohet edhe në opinionin më lart, shpalosjet lidhur me pasuritë financiare mbi 1,000€ nuk janë të sakta apo të plota.

<sup>4</sup> Termi „opinion i pamodifikuar” është ekuivalent me termin „opinion i pakualifikuar” i përdorur në versionin paraprak të Raportit Vjetor. Terminologjia e re është në pajtim me standardet të reja të INTOSAI-t (ISSAI 200). Për më shumë informacion referohu në shtojcën I.

Marrë parasysh këtë - Deklarata e bërë nga Ministri i MF-së dhe Drejtori i Përgjithshëm i Thesarit mund të konsiderohet e arsyeshme me përjashtim të shpalosjeve për pasuritë financiare mbi 1,000€.

### 3.3.1 Rreziqet domethënëse dhe çështje tjera në Pasqyrat Vjetore Financiare

Në Memon tonë të planifikimit të auditimit janë identifikuar dy rreziqe domethënëse në PVF/BK lidhur me pasuritë financiare mbi 1,000€ dhe pagesat nga palët e treta<sup>5</sup>. Rreziku i mëparshëm është materializuar siç u theksua më lart.

Rreziku i anomalive materiale që ne kemi identifikuar në lidhje me pagesat nga palët e treta nuk është materializuar. Diferenca mes vlerës së pagesave nga palët e treta në PVF/BK dhe PVF-të individuale nuk është materiale në nivel të PVF/BK.

Në vitin 2013, MF-ja ka hartuar udhëzime të qarta për trajtimin dhe prezantimin e pagesave nga palët e treta. Megjithatë, në PVF/BK janë raportuar vetëm 4,354,000€ pagesa nga palët e treta në krahasim me vlerën totale prej €28,748,000 të raportuara në PVF individuale të OB-ve. Nga kjo shumë, €11,963,345 janë bashkëfinancimet nga Ministritë e linjës, të cilat janë prezantuar gabimisht në PVF e OB-ve si pagesa nga palët e treta, duke lënë një diferencë prej 16,784,655€.

#### Çështjet tjera të konsolidimit

Përveç rreziqeve domethënëse të identifikuara më lart, ne kemi identifikuar edhe një numër fushash të tjera, të cilat ne nuk konsiderojmë që paraqesin rrezik domethënës për anomali materiale në pasqyrat financiare, por janë çështje të cilat duhet të merren në konsideratë nga Qeveria.

- Transaksionet ndërqeveritare nuk janë konsoliduar në PVF/BK duke rezultuar në mbivlerësimin e vlerave që bartin këto transaksione. E njëjta gjë ka ndodhur vitin e kaluar. Shpjegimi i Thesarit ishte se nuk e ka bërë konsolidimin e transaksioneve ndërqeveritare për hir të ruajtjes së konsistencës dhe krahasueshmërisë me informacionin e raportuar në vitet e mëparshme. Pasuritë jo kapitale në PVF/BK ishin mbivlerësuar për 2,646,926€ dhe detyrimet e papaguara ishin nënvlerësuar për 4,402,177€ në krahasim me vlerat totale në PVF individuale;
- Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) nuk kishte prezantuar shpenzimet për tarifën e likuidimit profesional të Ndërmarrjeve Shoqërore (NSH) në vlerën prej 4,009,126€. Kjo ka rezultuar në nënvlerësim të shpenzimeve në këtë vlerë për Mallra dhe Shërbime. (Kjo shumë ishte përfshirë gabimisht në pasqyrën e rrjedhës së parasë së gatshme të fondit të privatizimit); dhe

<sup>5</sup> Pagesat nga palët e treta janë pagesat direkte nga donatorët për OB-të apo në interes të Qeverisë së Kosovës. Këto pagesa nuk kalojnë përmes Llogarisë së Vetme të Thesarit (LLVTH). LLVTH është sistem i llogarive bankare të mbajtura në BQK, e kontrolluar nga Thesari/MF, e që shfrytëzohen nga institucionet shtetërore për inkasimin e të hyrave dhe pagesën e shpenzimeve.

- Planifikimi dhe buxhetimi i shpenzimeve në kategoritë jo adekuate dhe regjistrimi i shpenzimeve në kategori dhe kode të gabuara ekonomike vazhdon të jetë prezent. Vlera totale e keq klasifikimeve të shpenzimeve në të gjitha OB-të është 5,756,094€<sup>6</sup>. Kodi ekonomik 'Kapital Tjetër' përfshin gjithashtu zëra të regjistruar gabimisht në shumën prej 55,852,015€. Në këtë kod janë regjistruar gabimisht blerjet e kompjuterëve, zhvillim i softuerëve, riparime dhe renovime të ndërtesave, mjete pune, etj. Përveç kësaj, subvencionet e alokuara tek çdo përfitues, OJQ dhe biznese të cilat nuk janë entitete publike janë klasifikuar dhe regjistruar si subvencione ndaj entiteteve publike. Vlera e këtyre shpenzimeve të regjistruara në SIMFK është €16,175,665.

Këto dobësi zvogëlojnë transparencën dhe efektivitetin e raportimit financiar në një kohë kur partnerët ndërkombëtarë presin një menaxhim sa më efektiv financiar. Aspiratat për integrim në BE kërkojnë një regjim kontabiliteti efektiv.

### 3.3.2 Opinioneve e auditimit për PVF individuale

Auditimi i PVF/BK është përforcuar nga auditimet e rregullsisë të kryera në 88<sup>7</sup> OB. Dy<sup>8</sup> organizata të tjera të audituara janë jashtë BK-së. Përveç kësaj, janë kryer 13 auditime jo statutore (përfshirë dy fonde të donatorëve). Konkluzionet e auditimit jo statutor, në disa raste, formojnë bazën për disa nga pikëpamjet tona të shprehura në Kapitujt 4 dhe 5. Ndikimi i auditimeve të rregullsisë në PVF/BK është përmbledhur më poshtë:

**Tabela 1. Lloji dhe numri i opinioneve për PVF individuale të OB-ve.**

Nr. Ren.	Llojet e Opinioneve	Numri i Opinioneve	Ndikimi në PVF/BK
1	Opinion i pamodifikuar	35	0
2	Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes	46	Theksim i çështjes
3	Opinion i kualifikuar	2	Jo material
4	Opinion i kundërt	4	Jo material
5	Mohim i opinionit	2	Jo material
<b>Gjithsej</b>		<b>89<sup>9</sup></b>	

Theksimi i çështjes dhënë për vitin 2013 ka të bëjë kryesisht me shpalesje jo të saktë të pasurisë dhe pagesave nga palët e treta.

<sup>6</sup> Prej tyre, 3,993,823€ ishin planifikuar apo buxhetuar në kategori të gabuar ekonomike, ndërsa pjesa tjetër ishte klasifikuar gabimisht nga vet OB-të.

<sup>7</sup> PVF-të e Bankës Qendrore, Trustit Pensional dhe Agjencisë Kosovare të Inteligjencës nuk janë audituar nga ZAP.

<sup>8</sup> PVF e projektit TAMAD dhe DANIDA

<sup>9</sup> Dallimi mes numrit të institucioneve të audituara dhe opinioneve të dhëna është se Auditori i Përgjithshëm është i obliguar të japë dy opinione ndaras sa i përket AKP-së, një për institucionin dhe një për Fondin e Privatizimit

### 3.4 Analiza e PVF/BK për vitin 2013

Të dhënat e prezantuara në PVF/BK janë reflektim i pranimeve dhe pagesave reale dhe ndarjeve buxhetore përkatëse. Buxheti i Republikës së Kosovës për vitin 2013 i është nënshtruar rishikimit buxhetor (Ligji nr. 04/L-210 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 04/L-145), ku kishte ndryshime buxhetore edhe ndërmjet kategorive ekonomike në kuadër të OB-ve.

#### 3.4.1 Pasqyra e konsoliduar e krahasimit të buxhetit me ekzekutimin

Në raport me buxhetin fillestar, buxheti final ishte më i lartë si për pranimet ashtu edhe për pagesat (përkatësisht 48,939,000€ dhe 34,871,000€).

**Tabela 2: Buxheti fillestar dhe realizimi i pranimeve në raport me pagesat ( 000 në €)**

Përshkrimi	Buxheti Fillestar	Buxheti Final	Realizimi	Përqindja	Përqindja në 2012
	<b>A</b>	<b>B</b>	<b>C</b>	<b>D=C/B</b>	
Pranimet	1,527,000	1,575,939	1,428,704 <sup>10</sup>	90,7%	96,3
Pagesat	1,623,831	1,658,702	1,500,176 <sup>11</sup>	90,4%	92,5
<b>Deficiti</b>	<b>(96,831)</b>	<b>(82,763)</b>	<b>(71,472)</b>		

Deficiti vjetor prej 71,472,000€ ishte në masën 86.3% të shumës së planifikuar. Deficiti vjetor është 5% i të hyrave të përgjithshme vjetore dhe financohet nga suficiti i akumuluar ndër vite. Kjo reflektohet në zvogëlimin e bilancit të akumuluar bankar për vitin 2013.

#### 3.4.2 Pasqyra e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme

##### A. Analiza e pranimeve në para të gatshme

Pranimet përfshijnë burime të ndryshme të të ardhurave, si të hyrat tatimore dhe jo tatimore, të hyrat vetanake dhe pranime tjera përfshirë dividendat, letrat me vlerë, tantiema, taksat koncesionare, huamarrjen etj.

Të hyrat e përgjithshme të realizuara në nivel vendi janë 1,428,704,000€. Të hyrat tatimore të inkasuara nga Doganat e Kosovës (Doganat) dhe Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) përbëjnë 77% të të hyrave të përgjithshme në nivel vendi (71% në 2012 dhe 81% në vitin 2011).

Mungesa e përkrahjes buxhetore nga grantet e Bankës Botërore, niveli i ulët i të hyrave vetanake, mungesa e financimit të njëhershëm nga AKP-ja, dhe huamarrja më e ulët nga institucionet financiare ndërkombëtare janë faktorët që kanë ndikuar që pranimet e këtij viti fiskal të jenë 7% më të ulëta se ato të vitit 2012.

Pranimet e inkasuara në raport me planin përfundimtar dhe krahasimi me dy vitet paraprake sipas burimit të të hyrave është prezantuar në tabelën në vijim. Ajo thekson, për shembull, se vetëm 53% e planit për të hyrat vetanake të nivelit qendror ishte arritur.

<sup>10</sup> Kjo shumë nuk përfshin €12,587,607 nga Grantet e Përcaktuara të Donatorëve dhe €3,873,000 fonde nga depozita

<sup>11</sup> Kjo shumë totale nuk përfshin €11,179,000 nga Grantet e Përcaktuara të Donatorëve dhe €203,000 nga fondet nga depozita

Tabela 3: Buxheti dhe realizimi i pranimeve sipas burimeve të ndryshme për vitin 2013 (‘000 në €)

TË HYRAT DHE PRANIMET TJERA	Buxheti final	Realizimi 2013	Realizimi i buxhetit në %	Progresi krahasuar me vitin paraparak	Realizimi 2012	Realizimi 2011
	A	B	$C=(B/A)$	$D=(B-E/E)$	E	F
Të hyra nga Dogana	914,737	837,269	91.5%	-0.9%	844,861	827,704
Kthimet nga Dogana	(3,597)	(3,189)	88.7%	53.8%	(2,074)	(1,112)
Të hyrat nga ATK	300,964	305,448	101.5%	7.6%	283,915	261,134
Kthimet nga ATK	(30,990)	(34,685)	111.9%	5.9%	(32,763)	(29,774)
<b>I. Gjithsej të hyrat tatimore</b>	<b>1,181,114</b>	<b>1,104,843</b>	<b>93.5%</b>	<b>1.0%</b>	<b>1,093,939</b>	<b>1,057,952</b>
Të hyrat jo tatimore niveli qendror	44,048	43,080	97.8%	4.7%	41,145	45,525
Të hyrat vetanake të Komunave	63,020	55,850	88.6%	-6.1%	59,448	55,621
Të hyrat vetanake të nivelit qendror	72,535	39,103	53.9%	-12.8%	44,835	59,912
<b>II. Gjithsej të hyrat jo tatimore dhe të hyra vetanake</b>	<b>179,603</b>	<b>138,033</b>	<b>76.9%</b>	<b>-5.1%</b>	<b>145,428</b>	<b>161,058</b>
Taksat koncesionare	6,300	2,000	31.7%	100.0%	-	-
Tantiemat <sup>12</sup>	22,000	24,693	112.2%	100.0%	-	-
Dividentat	43,000	43,000	100.0%	-4.4%	45,000	60,000
Te hyrat nga privatizimi <sup>13</sup>	26,300	26,300	100.0%	100.0%	-	-
Të hyrat e dedikuara të AKP-së	-	-	0.0%	-100.0%	16,248	-
Financimi i njehershëm i AKP-së	-	-	0.0%	-100.0%	28,934	-
Kthimi i huasë nga NP	6,000	6,000	100.0%	50.0%	4,000	-
Pranimet nga emetimi i letrave me vlerë	80,000	79,200	99.0%	8.0%	73,313	-
Huazimet nga FMN dhe BB	31,621	4,634	14.7%	-95.1%	93,677	5,076
Grantet për përkrahje të buxhetit	-	-	0.0%	-100.0%	37,417	19,240
<b>III. Gjithsej pranime tjera</b>	<b>215,221</b>	<b>185,827</b>	<b>86.3%</b>	<b>-37.7%</b>	<b>298,589</b>	<b>84,316</b>
<b>Gjithsej të hyra dhe pranime (I+II+III)</b>	<b>1,575,939</b>	<b>1,428,704</b>	<b>90.7%</b>	<b>-7.1%</b>	<b>1,537,955</b>	<b>1,303,328</b>

<sup>12</sup> Janë të hyrat e pranuar nga licencat për gurëthyes dhe miniera.

<sup>13</sup> Të hyrat nga privatizimi në vlerë 26,300,000€ kanë të bëjnë me të hyrat e pranuar nga privatizimi i distribucionit elektrik të KEK-ut.

### **Të hyrat tatimore të realizuara nga Doganat**

Të hyrat e planifikuara për vitin 2013 ishin 915,000,000€, ndërsa janë inkasuar 837,268,927€ (bruto), ose 91.5%, një rënie prej 1% në krahasim me 2012. Kjo inkasim i ulët i të hyrave doganore është ndikuar nga nivelet më të ulëta seç është pritur të mallrave të importuara dhe rënia e konsumit.

### **Të hyrat tatimore të realizuara nga ATK**

Të hyrat e planifikuara për vitin 2013 ishin 300,964,000€, ndërsa janë inkasuar 305,447,912€ (bruto), ose 101.5%. Nga trendi i të hyrave vërehet se ATK ka një rritje të të hyrave me 7.6% gjatë vitit 2012 dhe 17% gjatë 2011. Faktorët që kanë ndikuar në rritjen e të hyrave janë: Deklarimi elektronik, dhe regjistrimi i biznesit përmes One-Stop-Shop; zhvillimet e një sistemi të fuqishëm për menaxhimin e pajtueshmërisë me planet vjetore për trajtimin e rreziqeve dhe vizitat e shpeshta dhe të shkurtra tek Operatorët Ekonomik (OE)

ATK ka vendosur kontrolle mbi inkasimin dhe raportimin e të hyrave. Megjithatë shqetësimi i ATK-së është shkalla e lartë borxheve të pa-inkasueshme, të cilat në fund të vitit 2013, ishin 253,496,704€.

Ekzistojnë disa dobësi që kanë nevojë për përmirësim si: vonesa në shqyrtimin e rimbursimeve, mos aplikimi i urdhër-vjeljeve për inkasimin e borxheve dhe mangësi në marrëveshjet për pagesën e obligimeve tatimore përmes kësteve. Si të tilla, ekziston potenciali për më shumë përmirësime në normat e inkasimit/zvogëlimin e borxheve.

### **Dividentat dhe taksat nga koncesioni**

Në buxhetin fillestar dhe atë të rishikuar, dividendat ishin planifikuar të jenë në shumën 30,000,000€. Dividentat e inkasuara dhe të përfshira në buxhetin final ishin në shumën 43,000,000€, nga të cilat, 40,000,000€ u pranuan prej PTK dhe 3,000,000€ prej Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të Energjisë Elektrike (KOSTT).

Dividenta e paguar nga PTK është 5,000,000€ më e ulët se ajo e vitit 2012, apo 15,000,000€ më e ulët krahasuar me vitin 2011. Ky trend i zvogëlimit të dividendave është për shkak se shërbimet e ofruara nga tregu i postës dhe telekomunikimit kanë rënë në mënyrë të vazhdueshme.

Taksat koncesionare nga Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës për vitin 2013 ishin planifikuar të jenë 6,300,000€, ndërsa janë inkasuar 2,000,000€. Ky nivel i ulët i inkasimit është shkak i një planifikimi jo real.

## **B. Analiza e pagesave në para të gatshme**

Investimet kapitale kanë pjesëmarrjen më të madhe në shpenzimet e përgjithshme, me 35,3%, e pasuar nga Pagat dhe Mëditjet me 27.8%, Subvencionet dhe Transferet me 20,9%, dhe Mallrat dhe Shërbimet 12,9%. Shpenzimet Komunale dhe pagesa e borxhit përfaqësojnë 3%.

**Tabela 4: Shpenzimet aktuale kundrejt buxhetit final** (‘000 në €)

<b>PËRSHKRIMI</b>	<b>Buxheti final</b>	<b>Realizimi 2013</b>	<b>%</b>	<b>Krahasimi 2013-2012</b>	<b>Realizimi 2012</b>	<b>Realizimi 2011</b>
Pagat dhe Mëditjet	437,696	417,093	95.3%	2.3%	407,706	385,033
Mallrat dhe Shërbimet	215,641	193,857	89.9%	14.5%	169,362	156,559
Shpenzimet Komunale	24,098	21,662	89.9%	0.5%	21,558	20,376
Subvencionet dhe Transferet	320,981	312,916	97.5%	11.7%	280,120	256,166
Shpenzimet Kapitale	627,457	529,176	84.3%	-3.8%	550,245	528,186
Rezervat	115	-	0.0%	0.0%	-	-
<b>Nën totali</b>	<b>1,625,988</b>	<b>1,474,704</b>	<b>90.7%</b>	<b>3.2%</b>	<b>1,428,991</b>	<b>1,346,319</b>
Pagesa e borxhit	32,713	25,472	77.9%	18.9%	21,416	11,491
Huazimet për NP	-	-	100.0%	100.0%	15,000	30,000
Anëtarësimi në IFN	-	-	100.0%	-100.0%	1,050	-
<b>Nën totali</b>	<b>32,713</b>	<b>25,472</b>	<b>77.9%</b>	<b>-32.0%</b>	<b>37,466</b>	<b>41,491</b>
<b>GJITHSEJ</b>	<b>1,658,702</b>	<b>1,500,176</b>	<b>90.4%</b>	<b>2.3%</b>	<b>1,466,457</b>	<b>1,387,810</b>

Në raport me vitin e kaluar, shpenzimet për Mallra dhe Shërbime janë rritur me 14.5% dhe për Subvencione dhe Transfere me 11.7%. Shpenzimet për Investime Kapitale janë zvogëluar me 3.8%.

Krahasuar me buxhetin final, realizimi i planit ishte në nivel të ulët. Kjo ishte për shkak se në fund të dhjetorit 2013, Qeveria mori vendimin për ti kursyer 80 milion euro dhe ti lë ato mënjanë si rezerva buxhetore për të shërbyer si masë ndaj rrezikut fiskal. Kategoria me ekzekutim më të ulët ishte ajo e Investimeve Kapitale me 83.4%. Ky nivel i ulët i realizimit ishte shkak i zbatimit të ngadalshëm të projekteve dhe vonesave në proceset e prokurimit të shkaktuara nga ankesat e dorëzuara në Organin Shqyrtues të Prokurimit (OSHP<sup>14</sup>). Rezultati i kësaj është humbja e mundësisë për të zbatuar programet kapitale dhe bartja e suficitit në vitin tjetër si detyrime.

OB-të nuk e kanë realizuar buxhetin vjetor sipas planeve të rrjedhës së parasë së gatshme. Ashtu si në vitet e tjera, shpenzimet në muajt e fundit të vitit janë rritur. Numri voluminoz të lëndëve për procedim në fund vit ka rezultuar me mangësi të kontrolleve në OB në lidhje me kompletimin dhe certifikimin e pagesave.

Grantet e Përcaktuara të Donatorëve (GPD) janë fonde, të cilat duhet të shfrytëzohen në pajtim me kushtet e marrëveshjeve dhe qëllimin e përcaktuar. Pjesa më e madhe e këtyre fondeve janë dedikuar dhe shfrytëzuar për Investime Kapitale dhe Subvencione e Transfere.

<sup>14</sup> Në mungesë të një bordi funksionues, OSHP nuk mundi të merrte vendim për ankesat e bëra nga palët në procesin e tenderimit.

Tabela 5: Grantet e përcaktuara të donatorëve

( 000 në €)

Emërtimi	2013	2012	2011
<b>Gjendja e granteve të bartura në fillim të vitit</b>	<b>8,301</b>	<b>6,423</b>	<b>9,741</b>
Grantet e pranuar	12,588	11,322	8,968
Pagesat direkte	4,354	5,493	4,642
<b>Totali i granteve të pranuar</b>	<b>16,942</b>	<b>16,815</b>	<b>13,610</b>
<b>Totali</b>	<b>25,243</b>	<b>23,238</b>	<b>23,350</b>
Shpenzimet nga grantet	(11,179)	(9,426)	(11,729)
Pagesat direkte	(4,354)	(5,493)	(4,642)
Kthimi i granteve	(91)	(18)	(556)
<b>Grantet e pa shpenzuara në fund të vitit</b>	<b>9,619</b>	<b>8,301</b>	<b>6,423</b>

Fondet e granteve nuk ishin shfrytëzuar në nivel të kënaqshëm. Shifrat në tabelën më lartë tregojnë se bilancet e mjeteve të pa shpenzuara nga fondet e granteve janë rritur gjatë tre viteve të fundit. Bartja e mjeteve të pashfrytëzuara nga viti në vit, tregon se këto fonde nuk po menaxhohen sa duhet dhe as nuk po shfrytëzohen për qëllimet e dedikuara. Kjo rrit rrezikun që grantet nga donatorët në të ardhmen do të zvogëlohen sepse shihet se ato nuk po menaxhohen në mënyrë aktive.

### Subvencionet

Subvencionet që u janë paguar përfituesve jo-publik, por regjistruar si përfituesve publik janë si më poshtë:

Tabela 6 Subvencionet e paguara përfituesve jo publik

(në €)

Përfituesit	2013	2012
Përfitues individual	280,801	764,082
Organizata jo Qeveritare	14,904,859	16,774,165
Biznese	990,005	752,659
<b>Gjithsej</b>	<b>16,175,665</b>	<b>18,290,906</b>

Krahasuar me vitin 2012, shuma totale e keq klasifikimit është 2,115,241€ më pak.

### Kreditë për Korporatën Energjetike të Kosovës (KEK)

Financimi i KEK-ut nga buxheti shtetëror është trajtuar edhe në raportet e auditimit të viteve të mëparshme. MF ka nënshkruar shtatë marrëveshje financiare (kredi) me KEK-un nga viti 2005 deri 2010 në vlerë të përgjithshme 239,152,550€. Shuma totale që KEK ka tërhequr nga buxheti i Kosovës në emër të kredive është 202,539,992€. KEK ka arritur të kthejë vetëm kredinë e parë të nënshkruar në vitin 2005 në vlerë 10,000,000€, ku 4,000,000€ janë kthyer në vitin 2012 dhe 6,000,000€ në vitin 2013. Për kreditë/fondet e përdorura KEK ka paguar interes në llogari të buxhetit në vlerë 7,081,488€, nga të cilat 1,710,176€ janë paguar gjatë vitit 2009 dhe 5,371,312€ në vitin 2010.

Me kërkesë të menaxhmentit të KEK-ut, në nëntor të vitit 2010, MF dhe KEK kanë amandamentuar marrëveshjet financiare (kredit) për KEK-un. Sipas këtyre amandamendimeve kthimi i kryegjësë dhe interesit ishte paraparë të fillonte nga viti 2012 deri në vitin 2021. Për periudhën 2012-2013, përveç kthimit të kredisë së parë, KEK nuk kishte bërë asnjë pagesë për gjashtë kredite tjera ekzistuese. Deri në fund të vitit 2013, vlera e kryegjësë që duhej të kthehej është 30,007,161€ ndërsa interesi 12,097,409€ apo në total 42,104,570€.

Në korrik 2013, Bordi i Drejtorëve (BD) të KEK-ut kishte kërkuar nga MF përkatësisht nga Komisioni Ndërmarrës për Ndërmarrjet Publike (KN/NP) që të ri-negociojë sërish dispozitat e gjashtë marrëveshjeve të kredisë. Propozimi ishte që afati i kthimit të kredive dhe tarifave tjera të shtyhej deri më 1 Maj 2014. Deri në përfundimin e auditimit ne nuk morëm ndonjë informatë nëse për këtë kërkesë ishte marrë vendim nga KN/NP-ja, dhe asnjë pagesë nuk ishte bërë.

### 3.4.3 Pasqyrat e Konsoliduara të pasurive në para të gatshme dhe bilancet e fondeve.

Bilanci i parasë së gatshme në fund të vitit përfshinë GPD, të hyrat vetanake të bartura apo të hyrat e inkasuara e të pa shfrytëzuara gjatë vitit 2013 nga komunat dhe OB-të; si dhe fondet në mirëbesim, në vlerë totale 52,490,000€.

Ne krahasuam të dhënat e prezantuara në Pasqyrën e Konsoliduar në Para të Gatshme dhe Bilancet e Fondeve me raportet bankare të BQK-së, si dhe kemi analizuar bilancet e fondeve ndërmjet viteve të fundit.

**Tabela 7: Pasuritë në para të gatshme dhe bilancet e fondeve** (‘000 në €)

PËRSHKRIMI	BILANCI NË 2013	BILANCI NË 2012	BILANCI NË 2011
Banka Qendrore e Kosovës	12,888	73,697	89,326
Letra me vlerë për Qeverinë	80,955	45,996	0
Depozitat e afatizuara jashtë vendit	113,008	152,007	105,042
Fondet në bankën NLB Prishtina	0	0	41
Paratë e gatshme në transit	3,039	5,115	7,074
Llogaritë e ambasadave dhe konsullatave të Republikës së Kosovës	406	448	961
Paratë e gatshme në dorë (arka)	1,482	907	1,184
<b>Gjithsej para e gatshme</b>	<b>211,778</b>	<b>278,170</b>	<b>203,628</b>

Bilanci i llogarive rrjedhëse të mbajtura në BQK është zvogëluar dukshëm në krahasim me dy vitet paraprake. Ndërsa kishte rritje të ekuivalentëve të parasë apo letrave me vlerë për Qeverinë. Paraja e gatshme në fund të vitit 2013 është zvogëluar për 66,392,000€ në krahasim me bilancin e vitit 2012 pasi mjetet e mbajtura mbuluan deficitin buxhetor të vitit 2013.

## 3.5 Shpalosja e pasurive jo financiare dhe detyrimet e papaguara

### 3.5.1 Pasuritë jo financiare

Menaxhimi i pasurisë publike është pjesë e veçantë e MFK-së<sup>15</sup>. Sipas PVF/BK, vlera neto e pasurisë jokapitale është 4,187,269,552€ e përbërë nga 1,848,661,630€ nga OB-të e nivelit qendror dhe 2,338,607,922€ nga ato të nivelit lokal.

Megjithatë, OB-të as nuk janë duke i trajtuar në mënyrë konsistente pasuritë e tyre në regjistrat kontabël dhe as nuk i raportojnë ato në pajtim me rregullat ligjore. Nëntë OB të nivelit lokal (përfshirë një që nuk kanë dorëzuar PVF) dhe dy të nivelit qendror nuk e kishin prezantuar fare pasurinë jokapitale. Kjo reflekton pjesërisht paqartësi lidhur me të drejtat e pronësisë ndaj disa pasurive dhe mungesë të dëshmisë për pronësinë e tyre. Po ashtu, mangësi kishte edhe të raportimi i vlerës bruto të pasurisë, kategorizimi i pasurisë dhe llogaritja e zhvlerësimit. Mungesë raportimi për stoqet apo materialin shpenzues kishte edhe tek 24 OB. Kjo tregon se OB-të edhe më tutje përballen me vështirësi në regjistrimin, klasifikimin dhe menaxhimin e pasurisë qeveritare.

Për shkak të mangësive në regjistrimin dhe shpalosjen e pasurisë, për 34 PVF të OB-ve të nivelit lokal dhe 12 PVF të OB-ve të nivelit qendror janë dhënë opinione me theksim të çështjes.

### E-Pasuria<sup>16</sup>

Ndonëse ky aplikacion ofron mundësi të shumta të regjistrimit dhe menaxhimit të pasurisë, janë hasur disa mangësi teknike. Ato kanë të bëjnë me zhvlerësimin e pasurisë dhe gjenerimin e raporteve me vlerë negative të pasurisë dhe sasisë negative të stoqeve. Zyrtarëve të pasurisë nuk i është ofruar trajnimi i duhur për përdorimin e këtij aplikacioni. Si rrjedhojë, në disa organizata e-pasuria nuk është duke u aplikuar fare.

### 3.5.2 Detyrimet e pa paguara

Aneksi 9 i PVF/BK dhe Neni 15, Shënimi 28 nga PVF-të individuale të OB-ve raportojnë detyrimet.

Obligimet e papaguara të organizatave buxhetore në fund të vitit 2013 kapin vlerën prej 53,626,720€ të cilat janë bartur për pagesë në vitin 2014, me një rritje prej 26,939,117€ apo mbi 100%. Prej tyre 16,065,063€ i takojnë nivelit qendror dhe 10,874,057€ nivelit lokal.

<sup>15</sup> Sipas kërkesave ligjore, pasuria kapitale (>1,000) duhet të regjistrohet në sistemin kontabël të thesarit (SIMFK), ndërsa pasuria jo kapitale (<1,000€) dhe stoqet (materiali shpenzues) duhet të regjistrohen në sistemin e-Pasuria.

<sup>16</sup> e-pasuria, është një aplikacion për ueb dhe sistem i integruar elektronik, i zhvilluar për nevojat e Qeverisë. e-Pasuria është pjesë e e-qeverisjes, dhe si projekt synohet të implementohet në të gjitha institucionet shtetërore. Përmes saj krijohet një bazë qendrore e të dhënave për menaxhimin efektiv të pasurisë publike. Ministria e Administratës Publike është bartës i këtij projekti.

**Tabela 8: Obligimet e papaguara krahasuar në tri vitet e fundit (në €)**

Përshkrimi	2013	2012	2011	Rritja midis 2012 dhe 2013 (€)	Rritja midis 2012 dhe 2013 (%)
Niveli Qendror	29,940,831	13,875,768	21,072,571	16,065,063	115.78
Niveli Lokal	23,685,889	12,811,832	18,123,248	10,874,057	84.88
<b>Gjithsej</b>	<b>53,626,720</b>	<b>26,687,600</b>	<b>39,195,819</b>	<b>26,939,120</b>	<b>100.98</b>

Kur detyrimet përbëjnë një pjesë të madhe të buxhetit të tyre, OB-të kanë gjasa të përballen me vështirësi buxhetore domethënëse në të ardhmen nëse nuk merren masa proaktive për të reduktuar këtë nivel.

**Tabela 9: Obligimet e pa paguara për disa OB individuale, në raport me buxhetin e tyre për vitin 2013 (në €)**

Organizatrat buxhetore	Buxheti final 2013	Detyrimet e papaguara 2013	Buxheti final në %
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	23,359,230.00	12,025,450.00	51.48
Shtërpçë	3,570,778.00	1,093,000.00	30.61
Gjakovë	19,931,360.00	5,345,056.00	26.82
Klllokot	1,093,000.00	285,608.00	26.13
Rahovec	10,384,259.00	2,202,988.00	21.21
Gjilan	21,356,768.00	4,112,630.00	19.26
Lipjan	12,305,133.00	1,246,034.00	10.13
Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	55,929,372.00	4,266,220.00	7.63
Prizreni	35,157,505.00	2,485,000.00	7.07
Ferizaj	22,991,734.00	1,606,000.00	6.99
Deçan	6,968,000.00	386,579.00	5.55
Mitrovicë	17,770,924.00	972,000.00	5.47

Detyrimet e papaguara të MBPZHR-së në vitin 2013 ishin rritur për 11,533,337€ krahasuar me vitin e kaluar. Rritja e detyrimeve është si rezultat i rritjes së zotimeve të cilat shoqërohen me përafrimin e qartë me politikat e BE-së. Megjithatë, arsyet më të shpeshta të mos pagesës nga OB-të individuale janë mungesa e fondeve, dorëzimi i faturave me vonesë nga OE dhe mos zotimi i mjeteve me kohë.

### 3.6 Adresimi i rekomandimeve të dhëna në vitin 2012

Adresimi i rekomandimeve të auditimit është një mekanizëm për promovimin e përmirësimit të menaxhimit financiar. Për ta mbështetur këtë proces, KMFP ka mbajtur takime publike me zyrtarët përgjegjës e llogaridhënës të OB-ve, por ende mbetet rasti që një numër rekomandimesh të rëndësishme nuk po adresohen nga OB-të si në vijim.

**Tabela 10 Zbatimi i rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm**

Organizatave Buxhetore	Rekomandime të adresuara	Rekomandime të adresuara pjesërisht	Rekomandime të pa adresuara	<b>Totali</b>
Niveli Qendror	163	112	88	<b>363</b>
Niveli Lokal	119	115	197	<b>431</b>
Institucionet e Pavarura	128	47	42	<b>217</b>
<b>Totali</b>	<b>410</b>	<b>274</b>	<b>327</b>	<b>1011</b>

Pjesa më e madhe e rekomandimeve të pa-adresuara ka të bëjë me organizatat e nivelit vendor/komunat. Mos adresimi i rekomandimeve të dhëna ka rezultuar në dobësi të vazhdueshme në kontrollin e brendshëm dhe në humbje financiare. Rekomandimet e pa-adresuara kanë të bëjnë me fusha si: saktësia e shpalosjeve në PVF, menaxhimi i të hyrave, procedurat e prokurimit, burimet njerëzore, subvencionet dhe pasuritë.

Raporti i auditimit për PVF/BK për vitin 2012 ka rezultuar me nëntë rekomandime kryesore drejtuar Qeverisë dhe një Kuvendit. Shumica e rekomandimeve mbasin të pa-adresuara si në vijim:

Dy rekomandimet e adresuara kanë të bëjnë me:

- Veprimet që MAP dhe MF kanë ndërmarrë për unifikimin e dy sistemeve për menaxhimin e pasurisë. Rregullorja MF-nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në OB ka qartësuar mënyrën e trajtimit, regjistrimit dhe menaxhimit të pasurisë qeveritare; dhe
- Shqyrtimin e ndikimit të donacioneve të reduktuara në planet e ardhshme të shpenzimeve në kuptim të kostos së pagave.

Edhe pse udhëzuesi i ri për pasuritë jo financiare është vënë në zbatim, asnjë përmirësim nuk është bërë në fushën e menaxhimit të pasurisë dhe raportimit financiar.

Dy rekomandimet e adresuara pjesërisht reflektojnë:

- Adresimin e rekomandimeve të mëparshme rreth dobësive të identifikuara në kontroll dhe menaxhimin jo efektiv; dhe
- Fokusimin në atë se sa efektive është Qeveria në adresimin e rekomandimeve të dhëna dhe kërkimin e raporteve mbi progresin e bërë para se të hartohen PVF/BK-së.

Adresimi i pjesërishëm i këtyre rekomandimeve nuk eliminon në tërësi dobësitë e identifikuar në raportimin financiar, menaxhimin dhe kontrollin e brendshëm. Në disa fusha vazhdojnë të jenë prezent dobësitë e njëjta.

Gjashtë rekomandimet e pa adresuara janë përmbledhur si në vijim:

- Baza për Theksim të çështjes në lidhje me konsolidimin e pasurive adresohet si çështje prioritare. Një task forcë duhet të themelohet dhe të raportojë në Kuvend brenda një periudhe tre mujore për të shqyrtuar çështjen e konsolidimit dhe dobësive në nivel të OB-ve sa i përket regjistrimit dhe vlerësimit të pasurisë. Një plan veprimi duhet të zbatohet për të arritur një përmirësim të dukshëm në nivel të BK-së dhe nivel të OB-ve individuale;
- Gjetjen dhe zbatimin e një zgjidhje të duhur gjatë vitit 2013 për trajtimin e borxheve të këqija, të dyshimta dhe të pa mbledhshme ;
- Mbikëqyrjen nga afër të zbatimit të marrëveshjeve për huatë e dhëna ndërmarrjeve publike (NP-ve), KEK për të siguruar se pagesat bëhen sipas afateve të përcaktuara;
- Transparencën në PVF/BK-së, duke klasifikuar dhe regjistruar të gjitha shpenzimet, me theks të veçantë subvencionet, në kodet adekuate të shpenzimeve, si dhe prezantimin e plotë të pagesave nga palët e treta;
- Analizimin e shkaqeve të detyrimeve të papaguara dhe ndërmarrjen e veprimeve të duhura për t'i zvogëluar ato në nivel të OB-ve; dhe
- Ngritjen e një task force të veçantë për shqyrtimin e realizimit të buxhetit dhe veprimet e ndërmarra lidhur me proceset e prokurimit dhe planifikimit për të hequr pengesat në rritjen e nivelit të realizimit të buxhetit. Theks i veçantë duhet të vihet tek pengesat për ekzekutimin efektiv të buxhetit për investimet kapitale.

Mos adresimi i rekomandimeve rezulton në mos efikasitet operativ dhe humbje të mundshme financiare. Më tutje, edhe këtë vit është përsëritur theksimi i çështjes për çështje që kanë të bëjnë me konsolidimin e pasurive sepse dobësitë në regjistrimin dhe menaxhimin e pasurive të qeverisë janë ende prezent: borxhet e pa inkasuara tatimore dhe mos bërja e ri-pagesave për kredinë e KEK-ut kanë shkaktuar humbje financiare të buxhetit; dhe klasifikimi jo i duhur i shpenzimeve ka rezultuar me nënvlerësim dhe mbivlerësim të shpenzimeve në kategoritë ekonomike përkatëse. Vlera e borxheve është dyfishuar në lidhje me ato të vitit të kaluar. Ekzekutimi i buxhetit në përgjithësi, duke përfshirë edhe investimet kapitale, nuk është në nivelin e pritur.

### 3.7 Rekomandimet e përgjithshme

Rekomandoj Qeverinë që të sigurojë se:

- Arsyet për Theksimin e Çështjes në PVF/BK për vitin 2013 janë analizuar dhe veprimet e nevojshme janë identifikuar për të adresuar këto dobësi të kontrollit në mënyrë që të mundësojë një prezantim të drejtë dhe të vërtetë të pasurive në PVF/BK 2014 dhe PVF;
- Masat e duhura janë marrë për të analizuar mangësitë e tjera në procesin e konsolidimit të PVF/BK siç janë: transaksionet ndër-qeveritare, pagesat nga palët e treta, pasuritë jo kapitale dhe klasifikimi i shpenzimeve. Në këtë aspekt, arsyet e mos implementimit të udhëzuesit të ri lidhur me pagesat nga palët e treta duhet të shqyrtohen. Ngjashëm, arsyetimi për mos konsolidimin e transaksioneve ndër qeveritare duhet të rivlerësohet dhe justifikohet zyrtarisht nëse nuk janë marrë masa për adresimin e kësaj pozite;
- Mekanizmat monitorues të aplikuar për performancën buxhetore janë përforcuar duke identifikuar dhe adresuar barrierat e mundshme ndaj ekzekutimit të buxhetit me një planifikim të buxhetit që paraprihet nga një proces rigoroz i vlerësimit. Me rastin e hartimit dhe rishikimit të buxhetit të bëhet klasifikimi i duhur i buxhetit varësisht nga vlera dhe natyra e shpenzimeve;
- Zbatohet një proces efektiv i menaxhimit të projekteve kapitale, duke siguruar monitorim pro-aktiv dhe veprim për të adresuar barrierat që pamundësojnë implementimin me kohë të kontratave sipas planeve dinamike;
- Është kryer një rishikim kritik për të siguruar përmbushjen e plotë të planit të inkasimit të të hyrave. Qeveria duhet të kërkojë më shumë llogaridhënie nga Agjencitë kryesore që inkasojnë të hyra për të siguruar që masat e kontrolleve për zbatimin e plotë të urdhër-vjeljeve dhe inkasimit të borxheve tatimore janë përforcuar;
- Është themeluar një task forcë për të analizuar dhe raportuar në Qeveri brenda një periudhe tre mujore lidhur me shkaktarët e rritjes së obligimeve nga viti në vit me qëllim që borxhet të reduktohen në një nivel të pranueshëm;
- Ministria e Financave duhet të sigurojë se KEK fillon të zbatojë marrëveshjet e amandamentuara për kreditë e tërhequra dhe se i përmbahet planit kreditor për pagesën e kryegjësë dhe interesit; dhe
- Programi e-pasuria është zbatuar në të gjitha institucionet qeveritare. Ministria e Administratës Publike, si pronar i programit e-pasuria duhet të marrë të gjitha veprimet e nevojshme për të shmangur dhe/ose adresuar të metat teknike të programit. Përveç kësaj, programe trajnimi duhet të sigurohen për zyrtarët përgjegjës për përdorimin e këtij aplikacioni.

## 4. Menaxhimi Financiar Publik

Menaxhimi dhe kontrolli i brendshëm i financave publike arrihet përmes një procesi të integruar të aktiviteteve të përditshme financiare dhe operative të OB-ve individuale. Iniciativa e Kontrollit të Brendshëm të Financave Publike (KBFP) ka për qëllim zbatimin e politikave efikase dhe reformimin e menaxhimit financiar, kontrollit dhe përmirësimin e llogaridhënies publike. Strategjia e KBFP-së synon përmbushjen e pritshmërive të praktikave të mira ndërkombëtare, të cilat duhet të zbatohen nga vendet candidate për anëtarësim në Bashkimin Evropian (BE).

Institucionet kryesore me përgjegjësi të veçanta qendrore në fushën e menaxhimit financiar mbeten MF-ja, Ministria e Administratës Publike (MAP) dhe Komisioni Rregullativ për Prokurimin Publik (KRPP).

Përmes këtij kapitulli ofrohet një pasqyrë e gjendjes aktuale në lidhje me menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm në institucionet shtetërore, dobësitë e identifikuara, vlerësimet dhe rekomandimet për zhvillimin e mëtejshëm të MF/K-së.

### 4.1 Planifikimi i buxhetit

Ndërkohë që buxheti për vitin 2013 është miratuar në kohë, procesi i shqyrtimit të buxhetit përfundoi shumë vonë (tetor 2013). Kjo rezultoi në përshtatjet e vonuara buxhetore dhe në mos ekzekutimin e buxhetit në nivelin e pritur. Në vitin 2013 ka pasur dobësi të tjera që lidhen me procesin e planifikimit të buxhetit, në nivel të përgjithshëm dhe në nivel projekti. Kjo u theksua nga:

- Tepriat buxhetore
- Planifikimi buxhetor për skemat sociale dhe të pensionit bazuar në informacion të pamjaftueshëm;
- Buxhetimi, kontimi dhe raportimi i transaksioneve në kodet e gabuara ekonomike duke rezultuar në prezantimin e transaksioneve në PVF; dhe
- Ekzekutimi i dobët i buxhetit kryesisht për projektet kapitale, por edhe për kategoritë e tjera ekonomike.

Aprovimi i vonshëm i rishikimit të buxhetit dhe vendimeve të tjera të Qeverisë për shkurtime buxhetore ka pasur padyshim ndikim në performancën buxhetore të OB-ve. Kjo situatë nuk mund të konsiderohet si praktikë e mirë.

### 4.2 Menaxhimi financiar/kontrolli dhe Sistemi i auditimit të brendshëm

Departamenti Qendror për Harmonizim (DQH) përbëhet nga dy divizione, Divizioni i Auditimit të Brendshëm (AB) dhe Divizioni i MFK-së.

Në nëntor 2013, udhëheqësi i ekipit të projektit të financiar nga BE për mbështetje ndaj DQH-së dha dorëheqje. Mangësitë në aktivitetet në periudhën para kësaj kanë pasur një efekt negativ në zhvillimin e mëtejshëm të MF/K-së dhe auditimit të brendshëm. Megjithatë, në shkurt 2014 është emëruar një udhëheqës i ri i ekipit dhe aktivitetet janë ri-strukturuar.

#### 4.2.1 DQH/MF/K

DQH/MF/K ka përgjegjësinë që të hartojë politika, dokumente strategjike dhe udhëzime në fushën e MF/K-së, të vlerësojë përshtatshmërinë dhe efektivitetin e sistemeve të MF/K-së në OB-të, si dhe përgatitjen e programeve dhe trajnimeve për zyrtarët publik.

DQH-ja ka bërë progres të ngadaltë në zhvillimin e MF/K-së në sektorin publik, pjesërisht për shkak të procesit të riorganizimit të kornizës institucionale, që mori më shumë kohë seç pritej. Një tjetër shpjegim është mungesa e kapacitetit të pamjaftueshëm profesional që nevojitet për ta zbatuar atë në mënyrë efektive.

Korniza ekzistuese rregullative e MF/K-së ka ende nevojë për qartësim dhe azhurnim pas zhvillimeve të fundit në fushën e MF/K-së dhe AB-së. Zbatimi i legjislacionit po ashtu nuk është mjaft i mirë. Në disa OB nuk ka rregullore specifike të brendshme të cilat do të mund të rregullonin kërkesat e përgjithshme të MF/K-së sipas fushave specifike të politikave.

Pjesë esenciale e zhvillimit dhe zbatimit të procedurave të MF/K-së është edhe vet-vlerësimi nga OB-të lidhur me udhëheqjen, personelin, kontrollin e brendshëm, menaxhimin e rrezikut dhe menaxhimin financiar.

#### 4.2.2 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Është përgjegjësi e institucioneve shtetërore të vendosin dhe zhvillojnë një sistem funksional të kontrollit të brendshëm dhe të sigurojnë menaxhim të mirë financiar. Menaxherët e lartë të organizatave janë përgjegjës për zbatimin e rregullave, procedurave dhe sistemeve për të siguruar përmbushjen e objektivave të synuara. MF/K duhet të zbatohet në të gjitha strukturat, programet, operacionet dhe proceset e menaxhuara nga ata, duke respektuar parimet e ligjshmërisë, menaxhimit të mirëfilltë financiar dhe transparencës.

Gjendja aktuale tregon se ende ka vështirësi për të kuptuar si duhet konceptet e MF/K-së dhe llogaridhënies menaxheriale. Nuk është aplikuar llogaridhënie për shpenzimin e buxhetit dhe për arritjen e objektivave organizative sipas standardeve të cilësisë së paracaktuar. Si rrjedhojë, rezultatet e synuara nga zbatimi i MF/K-së ende nuk janë arritur.

Menaxhimi i rrezikut<sup>17</sup> është komponentë kyçe e MF/K-së për të identifikuar, vlerësuar dhe monitoruar rreziqet dhe për të zbatuar kontrole, të cilat janë të nevojshme për të reduktuar ekspozimin ndaj rrezikut në një nivel të pranueshëm. Megjithatë, ka shumë pak aranzhime formale për vlerësimin dhe menaxhimin e rrezikut pasi ky proces nuk është kuptuar sa duhet në nivel menaxherial.

Efektiviteti dhe aplikimi konsistent i MF/K-së në praktikë vazhdon të jetë një sfidë e cila duhet të trajtohet më seriozisht nga menaxherët e lartë. Kontrollat e brendshme duhet që të vlerësohen vazhdimisht në aspektin e mjaftueshmërisë, përshtatshmërisë, funksionalitetit dhe raportit kosto-benefit. Një vlerësim i tillë duhet të bëhet rregullisht dhe në këtë drejtim duhet të krijohet një politikë dhe qasje më efikase.

Procesi i vet-vlerësimit është kërkesë ligjore, jo të gjitha organizatat e kanë zbatuar këtë proces. Vetëm gjysma e OB-ve kanë dorëzuar vet-vlerësimin në MF. Edhe në ato raste kur

---

<sup>17</sup> Rreziku përkufizohet si mundësi e shfaqjes së një ndodhie me ndikim negativ dhe që pengon arritjen e objektivave të organizatës.

është bërë raportimi, cilësia e vlerësimit është e dobët dhe ndikimi i çështjeve të ngritura nuk është kuptuar sa duhet. Në shumicën e rasteve, pohimet dhe vlerësimet e prezantuara në listat verifikuese të vetë-vlerësimit nuk janë dëshmuar me dokumente mbështetëse.

Se llogaridhënia menaxheriale nuk është zhvilluar sa duhet e tregon edhe fakti që vetëm një numër i vogël i OB-ve të nivelit qendror kanë përgatitur dhe dorëzuar raportin e performancës vjetore në MF. Raportimi vjetor është një kërkesë e LMFPP-së dhe MF/K-së. Përmes këtyre raporteve, Kuvendi, palët e tjera të interesit, media dhe publiku i gjerë informohet për mënyrën se si organizata ka performuar gjatë vitit në krahasim me rezultat e pritura, shërbimet e ofruara, dhe për efektivitetin e organizatës në arritjen e rezultateve.

Mangësitë e shumta të identifikuara në OB tregojnë nevojën e ngritjes së kapaciteteve dhe avancimit të mëtutjeshëm të sistemit të MF/K-së për ta mbështetur pajtueshmërinë me kontrollet dhe plotësinë e tyre. Në shumicën e rasteve mungojnë procedurat e shkruara. Aktivitetet e përditshme operative zhvillohen duke u bazuar vetëm në ligjet dhe rregulloret e përgjithshme. Prezenca e dobësive në shumë aspekte të sistemit, është tregues se zbatimi praktik i procedurave të MF/K-së ka ngecje.

Me gjithë angazhimin e OB-ve që të vendosin sisteme të menaxhimit dhe kontrollit, në praktikë ato nuk kanë funksionuar si duhet në parandalimin, zbulimin ose adresimin e mangësive ekzistuese. Kontrollet në aspektin e planifikimit dhe menaxhimit të buxhetit, sistemit të prokurimit, menaxhimit të projekteve kapitale, të hyrave, subvencioneve dhe menaxhimit të pasurisë, kanë nevojë për përmirësim të mëtejshëm.

#### 4.2.3 DQH/AB

Aktivitetet e DQH/AB për vitin 2013 rezultuan me një udhëzim të rishikuar administrativ për themelimin e funksionit të auditimit të brendshëm si dhe një udhëzim mbi licencimin e auditorëve të brendshëm që ende janë në fazën e hartimit. Trajnimi i CIPFA-së dhe programi i certifikimit ka vazhduar, duke përfshirë pilot auditimin e parë që filloi në nëntor të vitit 2013. Përkrahur nga këshilltari i projektit të KBFP-së, stafi i DQH/AB kishte kryer kontroll të cilësisë të njësive të auditimit të brendshëm në tre OB.

Raporti i konsoliduar mbi cilësinë e auditimit të brendshëm për vitin 2013 u publikua në prill të vitit 2014.

Sistemi i auditimit të brendshëm<sup>18</sup> duhet të jetë një mbështetje e rëndësishme për menaxherët e sektorit publik për të konfirmuar efektivitetin apo jo efektivitetin e sistemeve dhe proceseve. Pavarësisht zhvillimit në vitin 2013, auditimi i brendshëm mund të sigurojë mbështetje të mëtejshme menaxherëve marrë parasysh përsëritjen e vazhdueshme të të gjeturave në qeverisje dhe menaxhim financiar të cilat tregojnë se sistemi ekzistues nuk funksionon si duhet.

Siç theksohet në raportet e mëparshme vjetore të auditimit, sistemi aktual i auditimit të brendshëm nuk mbulon ndërmarrjet publike (NP-të). Ky kufizim shkaktohet nga korniza ekzistuese ligjore. Në fakt ligji aktual mbi ndërmarrjet publike e bën të pazbatueshëm ligjin për auditimin e brendshëm. Arsyetimi për këtë nuk është i qartë. Ne nuk kemi informacione

---

<sup>18</sup> Sistemi përfshin auditorë të brendshëm dhe komisionet e auditimit në organizatat buxhetore dhe Departamentin Qendror të Harmonizimit

se janë ndërmarrë veprime për të analizuar se si auditimi i brendshëm në kuadër të NP-së do të mund të integrohej në sistemin e përgjithshëm.

Disa nga sfidat e identifikuar lidhur me këtë fushë kanë nevojë për rishikim të kornizës ekzistuese ligjore, që aktualisht është ndërmarrë nga DQH/AB me ndihmën e ekspertëve të projektit të BE-së.

DQH/AB ka vazhduar me organizimin e skemës së certifikimit për auditim të brendshëm. Numri i auditorëve të brendshëm të certifikuar është 32. Gjatë vitit 2013, kanë filluar trajnimet për certifikimin e grupit të dytë të auditorëve, ku edhe 25 auditorë tjerë të brendshëm kanë kaluar provimet e skemës së certifikimit. Si rrjedhojë, 40% e auditorëve të brendshëm në sektorin publik (duke mos përfshirë NP-të) do të certifikohen.

Skema e certifikimit e ofruar nga CIPFA (dhe e financuar nga BE-ja) ofron nivel bazik të njohurive për praktikuesit e auditimit të brendshëm. Megjithatë, kjo nuk është në nivelin e certifikimit që ofrohet nga Instituti për Auditorë të Brendshëm (IAB). Palët e interesit presin nga auditorët e brendshëm të jetë në gjendje të kryejnë profesionin në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare.

Edhe pse trajnimet ofrohen nga trajnerët vendor, qëndrueshmëria sipas dizajnit aktual është e diskutueshme. Është e rëndësishme të merret parasysh një skemë e re e certifikimit, e organizuar, financuar dhe mirëmbajtur nga vendorët. Kjo duhet të jetë në përputhje me Kornizën Ndërkombëtare të Praktikave Profesionale të IAB-së.

Për të ecur në të njëjtin hap me zhvillimet profesionale dhe zhvillime të tjera, është e rëndësishme që auditorët e brendshëm të bëhen anëtarë të një shoqate profesionale dhe të përdorin mundësitë e rrjetëzimeve, të cilët mund ti ndihmojnë ata në zhvillimin e tyre të vazhdueshëm profesional. Se si do të ndërtohet një shoqatë e auditimit të brendshëm në Kosovë është diçka që duhet të merret parasysh nga të gjithë auditorët e brendshëm dhe DQH/AB duke siguruar mbështetjen ndërkombëtare për shkëmbimin e njohurive, përvojën si dhe zhvillimin e vazhdueshëm profesional.

Me ndihmën e projektit të KBFP-së, DQH/AB-ja ka filluar diskutimet për nevojën e zhvillimit të një programi të ri të ZHVP-së për auditorë të brendshëm. Është mbajtur një punëtori për planifikim strategjik të auditimit të brendshëm dhe janë realizuar disa pilot auditime të brendshme. Ndikimet e këtyre masave janë ende të kufizuara.

#### 4.2.4 Auditimi brendshëm

Për t'i ofruar siguri menaxhmentit (ose e kundërta) për veprimtarinë e të gjitha sistemeve të rëndësishme në një organizatë, nevojitet një plan vjetor i auditimit bazuar në rrezik, i realizuar nga stafi i kualifikuar.

Rreth 20% e planeve të rishikuara të auditimit të brendshëm nuk arritën të identifikojnë fushat me rrezik të lartë, duke sugjeruar kështu mungesën e një kornize të duhur për menaxhimin e rrezikut.

Për më tepër, fokusi i auditimit të brendshëm ende ndërlidhet në masë të madhe me informacionin financiar. Aktivitetet konsultuese ende mbesin në një nivel shumë të ulët në krahasim me sigurimin e dhënë nga testimi i pajtueshmërisë. Derisa fokusi në aktivitetet e vitit aktual është përmirësuar, 10% e aktiviteve përsëri ishin të fokusuar në aktivitetet viteve të kaluara. Potenciali për ndryshim nga një punë e tillë është i kufizuar.

Disa njësi të auditimit të brendshëm nuk ishin në gjendje të përfundonin planin e tyre vjetor. Mungesat në staf, menaxhimi i dobët i auditimit të brendshëm dhe trajnimet për programin e certifikimit ishin disa nga arsyet për këtë.

Udhëzimet për metodologjinë e auditimit janë funksionale por kanë nevojë për përditësim të rregullt. Megjithatë, cilësia e auditimeve të brendshme të kryera duhet të zhvillohet në mënyrë që të përmbushen standardet ndërkombëtare të auditimit dhe praktikat e mira evropiane. Qasja e auditimit ndaj sistemeve të kontrollit të brendshëm nuk është në nivel të duhur në drejtim të të kuptuarit të duhur dhe analizave efektive.

Fokusi i planeve të auditimit dhe aftësia e auditorëve të brendshëm ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë e raporteve. Derisa cilësia e raporteve të auditimit të brendshëm është përmirësuar paksa, ato ishin të orientuara kryesisht në pajtueshmëri. Rekomandimet e dhëna përqendrohen në masat e tjera ligjore me pak vëmendje të treguar ndaj përmirësimeve sistematike. Si të tilla, ato rrallë ofrojnë bazë për ndryshim dhe zhvillim.

Për shkak të kufizimeve buxhetore, shumë njësi të auditimit të brendshëm ende nuk kanë arritur të kompletojnë numrin e duhur të auditorëve. Ministria e Diasporës, shtatë komuna dhe një institucion i pavarur nuk kanë krijuar ende njësi të auditimit të brendshëm. MF gjatë vitit 2013 ka ofruar shërbime të auditimit të brendshëm për nëntë agjenci të vogla dhe Ministrinë e Diasporës, ndërsa nuk arritur të përmbush disa kërkesa të tjera.

Rreth 46% e njësive të auditimit të brendshëm përbëhen nga vetëm një auditor i brendshëm. Njësi të vogla e auditimit të brendshëm mund të kenë të vështirë të sigurojnë stafin i cili do të kishte aftësitë e nevojshme të ndërmarrë një plan gjithëpërfshirës të auditimit të brendshëm. Në këtë situatë, ekziston rreziku që plani i auditimit të përcaktohet më shumë nga aftësitë e stafit në dispozicion në vend të nevojave të entitetit.

Diskutimet filluan në vitin 2012 dhe rekomandimet e dhëna në lidhje me krijimin e një shërbimi të auditimit të brendshëm në Kuvend për të siguruar mbështetje për institucionet më të vogla të pavarura nuk kanë rezultuar me ndonjë zhvillim deri më tani.

Komitetet e Auditimit (KA-të) të forta duhet të ndërtojnë besimin e publikut dhe besimin në atë se si OB-të menaxhohen, forcimin e pavarësisë si dhe vlerën e aktivitetit të auditimit të brendshëm. Megjithatë, rreth 20% e institucioneve, kryesisht komunat nuk kanë krijuar KA-të.

Për më tepër, derisa numri i KA-ve është rritur në vitin 2013, efektiviteti i aktiviteteve të tyre është i diskutueshëm. Një numër i madh i tyre nuk i kanë kryer detyrat e tyre siç është pritur.

Mungesa e mbështetjes në promovimin e një cilësie të lartë të programit të auditimit të brendshëm, komunikimi i kufizuar me Menaxhmentin e lartë të OB-së dhe niveli i ulët i rekomandimeve të adresuara sugjerojnë fushëveprim të rëndësishëm për përmirësimin e efektivitetit të ekipeve të auditimit të brendshëm dhe KA-ve në OB.

### 4.3 Reformat në Shërbimin Civil dhe kompensimet

Në vitin 2013, Reforma në Shërbimin Civil (SHC) ka pasur progres për sa i përket hartimit të kornizës ligjore. Po në vitin 2013, ishte hartuar Rregullorja për Planifikimin e Personelit në Shërbimin Civil. Ajo ishte aprovuar në mars 2014 (nr. 02/2014). Zhvillime të mëtejshme pozitive përfshijnë:

- Sistemi i Informacionit për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore (SMIBNJ) tashmë është vënë në zbatim. Edhe pse me disa vonesa, faza e zbatimit të këtij projekti ka filluar në vitin 2014; dhe
- Trajnimet për stafin në SHC janë ofruar vazhdimisht nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike (IKAP).

Megjithatë, mos zbatimi i plotë Rregullore 09/2012<sup>19</sup>, e ka bërë të pazbatueshme Rregulloren Nr. 05/2012 për klasifikimin e vendeve të punës në shërbimin civil. Situata e tillë e ka pamundësuar aplikimin e sistemit të ri të pagave dhe vlerësimit.

Po ashtu, për sa i përket avancimit të stafit të SHC bazuar plotësisht në vlerësimin e nëpunësve civilë, nuk ka pasur të arritura në 2013. Arsyeja për këtë vonesë është se procedurat e reja të avancimit nuk mund të aplikohen pa u bërë klasifikimi i vendeve të punës.

Organizimi i sistemit të pagave në SHC bëhet përmes një sistemi të centralizuar i cili menaxhohet nga MAP. Pagat e nëpunësve civilë përfshijnë pagën bazë dhe shtesat. Këto dhe kompensimet e tjera financohen nga Buxheti i Përgjithshëm, e në disa raste edhe nga grantet e përcaktuara të donatorëve.

Numri i përgjithshëm i punëtorëve në sektorin publik i aprovuar me Ligjin e rishikuar të buxhetit për vitin 2013 ishte 79,906. Sipas listave të pagave të menaxhuara nga MAP, numri aktual i të punësuarve në muajin e fundit të vitit ishte 78,995. Të punësuar me status të rregulluar sipas Ligjit për shërbimin civil janë 21,737. Në tabelën në vijim janë prezantuar shpenzimet vjetore të pagave të rregullta dhe pagave retroaktive për vitin aktual dhe vitit paraprak.

---

<sup>19</sup> Rregullore për standardet e organizimit të brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës për organet e administratën shtetërore

Tabela 11: Shpenzimet vjetore për paga dhe mëditje (në €)

Përshkrimi	Pagat e rregullta 2013	Pagat retroaktive 2013	Pagat totale 2013	Pagat totale 2012
Pagat neto përmes listës së pagave	354,666,477	1,370,157	356,036,634	348,416,031
Tatimi i ndalur në burim në paga	18,955,087	66,942	19,022,029	18,338,383
Kontributi pensional nga punëtori	19,697,902	74,209	19,772,111	19,335,275
Kontrib. pensional nga punëdhënësi	19,697,902	74,209	19,772,111	19,335,275
Pagesa për sindikatë	1,221,184	-	1,221,184	1,209,922
<b>Totali</b>	<b>414,238,552</b>	<b>1,585,517</b>	<b>415,824,069</b>	<b>406,634,886</b>

Sipas PVF/BK shpenzimet për Paga dhe Mëditje për vitin 2013 ishin 418,546,000€. Prej të cilave, 417,093,000€ janë paguar nga Buxheti i Kosovës dhe 1,453,000€ nga grantet e përcaktuara të donatorëve.

Shuma 1,268,929€ ishte paguar përmes SIMFK-së. Bërja e pagave përmes SIMFK-së, duke anashkaluar sistemin e listës së pagave tregon mungesë të kontrolleve përkatëse në këtë fushë.

Bazuar në buxhetin e final të vitit 2013, paga mesatare mujore në shërbimin civil në nivel të përgjithshëm ishte 456€. Megjithatë, paga mesatare mujore ndryshon ndërmjet OB-ve. Nivel më i ulët i pagës mesatare mujore paraqitet tek niveli komunal.

Raportet individuale të auditimit të OB-ve tregojnë se ka mangësi sa i përket menaxhimit dhe kontrolleve në këtë fushë, të cilat kryesisht kanë të bëjnë me:

- Procedurat e rekrutimit pa konkurse;
- Pozitat drejtuese të mbajtura nga ushtrues detyre përtej afatit kohor ligjor;
- Mos aplikimin e saktë të kontratave të punësimit dhe pagesën e pagave më të larta sesa koeficientët e specifikuar në kontratë;
- Pagesën e pagave shtesë të pa aprovuara dhe pa dëshmi të mjaftueshme, nga kategoria e Subvencioneve (për komisione), dhe nga fondi për kuadro;
- Gradime dhe emërimet në stafin e SHC pa baza të mjaftueshme; dhe
- Përgatitjen dhe mirëmbajtjen e dosjeve të personelit.

#### 4.4 Prokurimi publik

Në vitin 2013 rreth 616 milionë euro, apo rreth 40% e shpenzimeve të BK-së, ishin shpenzuar përmes prokurimit në 90 OB (përfshirë agjencitë ekzekutive).

Agjencia Qendrore e Prokurimit (AQP), e themeluar në vitin 2012, ende nuk ka implementuar një prokurim të vetëm të centralizuar apo një kontratë kornizë. Ndikimi i kësaj mangësie është humbja e mundësisë së sektorit publik për të arritur ekonominë e shkallës dhe për të kursyer në kosto.

Përveç kësaj, ka pasur disa zhvillime pozitive. Për shembull, prokurimi gjatë vitit 2013 ka ulur vlerën e procedurave të negociuara pa publikim të njoftimit për kontratë.

Në raportin e KRRPP-së thuhet se sistemi i prokurimit është duke bërë progres nga viti në vit dhe është duke u bërë më transparent. Megjithatë, raportet tona individuale nxjerrin në pah se zbatimi i kornizës ligjore të prokurimit nuk është në një nivel të kënaqshëm dhe se janë identifikuar shumë shkelje dhe parregullsi.

Megjithatë, prokurimi mbetet sfidë për Qeverinë dhe Autoritetet Kontraktuese dhe dobësitë e theksuara në vitin 2013 janë përsëritje e atyre të vitit 2012.

Mangësitë më të shpeshta të identifikuara në 2013 janë:

- Rritja e kontratave me kuotim të çmimit dhe vlerë minimale;
- Dhënia e kontratave OE të papërgjegjshëm;
- Dhënia e kontratave pa zotim të mjeteve;
- Blerje jo në pajtim me ligjin e buxhetit/udhëzimet administrative;
- Vonesë në implementim të kontratës;
- Pagesa për Mallra dhe Shërbime nga Investimet Kapitale;
- Urdhër-blerja bëhet pas pranimit të faturës;
- Siguria e ekzekutimit nuk mbulon periudhën e implementimit;
- Mos informimi i OE të pasuksesshëm/eliminuar;
- Mungesa e Komisionit të Pranimit;
- Dhënia e kontratës pa procedurë prokurimi;
- Mungesa e nënshkrimeve në Deklaratën e Nevojave;
- Blerje në kundërshtim me specifikimin teknik;
- Certifikimi i pagesës pa dëshmi të mjaftueshme;
- Tejkalimi i limitit për punë shtesë;
- Vlerësim i dobëti i nevojave; dhe
- Mos Aplikimi i ndëshkimeve/penaleve për mos përmbushje të kërkesave kontraktuale.

Unë kam rekomanduar menaxhmentin e OB të sigurojë që këto çështje të adresohen sipas nevojës në secilën organizatë.

## 4.5 Rekomandimet e përgjithshme

### Unë rekomandoj Qeverinë që të sigurojë se:

- Ministria e Financave shqyrton efikasitetin e procesit të vetë-vlerësimit të MF/K-së si një mjet i projektuar për zhvillimin e përgjithshëm të qeverisjes publike. Ai duhet të analizojë më tej arsyet se pse nuk përdoret nga të gjithë OB-të si duhet dhe pse, atëherë kur përdoret, ai rrallë jep informata të mjaftueshme dhe të përshtatshme. Përdoruesve të tij duhet ti jepet më shumë mbështetje duke siguruar se cilësia e procesit dhe informacionit për gjendjen e MF/K-së të forcohet më tej. Përdorimi i shembujve të mirë si model mund të jetë një ndihmesë;
- Krerët e organizatave buxhetore i kushtojnë vëmendje të veçantë kërkesave për Planet e Veprimeve për adresimin e rekomandimeve të auditorit. Me të pranuar raportin përfundimtar të auditimit, secila OB duhet të caktojë qartë prioritetet dhe afatet kohore për masat;
- Kreu i çdo organizate buxhetore fillon të hartojë një raport të performancës çdo vit. Ky raport duhet të përfshijë, ndër të tjera, informacionin bazë për aktivitetet dhe rezultatet të matura kundrejt objektivave të politikave të përcaktuara paraprakisht;
- Mundësia për të integruar raportimin e performancës me raportimin financiar në Pasqyrave Vjetore Financiare të merret parasysh. Ky angazhim i ri për raportim do të siguronte një bazë më të mirë për të kërkuar llogari nga menaxherët për atë çka kanë shpenzuar dhe arritur;
- Procesi i menaxhimit të rrezikut në organizatat buxhetore është përforcuar. Rreziku më domethënës duhet të identifikohet në secilën organizatë dhe veprime duhet të ndërmerren për të prioritzuar dhe zbutur rreziqet. Ministria e Financave duhet të jetë proaktive e të ndihmojë krerët e OB-ve në përmbushjen e përgjegjësive të tyre për menaxhimin e rrezikut dhe ti udhëzojë ata në hartimin e politikave dhe planeve të duhura si dhe në zbatimin e tyre efektiv në praktikë;
- Duhet të konsiderojë marrjen e masave të menjëhershme për forcimin e cilësisë së auditimeve të brendshme të kryera në kuadër të NP-ve. Auditorët e brendshëm të NP-ve duhet të jenë pjesë e të njëjtit zhvillim profesional siç janë edhe auditorët e tjerë të brendshëm të sektorit publik dhe t'i nënshtrohen të njëjtit kontroll të cilësisë si për auditimet e brendshme të kryera brenda OB-ve. Një nga hapat e nevojshme për ta bërë këtë është të fillojë ndryshimi i ligjit mbi NP-të;
- Ministria e Financave të gjejë një zgjidhje të qëndrueshme për sa i përket futjes në përdorim të certifikimit të përshtatshëm për auditorët e brendshëm bazuar, për shembull, në Kornizën Ndërkombëtare të Praktikave Profesionale të Institutit të Auditorëve të Brendshëm, të analizojë modalitetet për rritjen e cilësisë së Komiteteve të Auditimit, të lehtësojë krijimin e një shoqate profesionale për auditorë të brendshëm dhe të fusë në përdorim udhëzimet e përgjithshme për planifikimin e auditimit të brendshëm bazuar në rrezik dhe për ofrimin e trajnimit të duhur për auditorët e brendshëm se si të përdorin atë në praktikë;

- Ministria a Administratës Publike të shtyjë përpara zbatimin e reformës në Shërbimin Civil. E gjithë korniza ligjore për SHC duhet të jetë e organizuar, duke bërë të mundur zbatimin e një sistemi të ri të pagave dhe të vlerësimit. Parakushtet për zbatim të plotë së Sistemit të Informacionit për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore duhet të krijohen;
- Kontrollat menaxheriale në lidhje me kompensimet shtesë dhe proceset e rekrutimit në mënyrë që të mundësojë transparencën dhe vendimet e bazuara mbi meritën; dhe
- Agjencia Qendrore e Prokurimit të fillojë me kontrata kornizë dhe me prokurime të centralizuara gjatë vitit 2014 për artikujt e zgjedhur në mënyrë që të sigurojë se sektori publik përfiton nga ekonomia e shkallës.

#### **Unë rekomandoj Kuvendin që të marrë në konsideratë nevojën për të:**

- Kërkuar llogari nga Qeveria për adresimin e rekomandimeve të mësipërme dhe të vendosë mekanizma efektive për përcjelljen e masave të marra; të nxisë Komisionin Rregullativ për Prokurim që të përshejtojë futjen në përdorim të prokurimit elektronik në mënyrë që të arrijnë transparencë më të mirë dhe thjeshtësimin e proceseve të prokurimit;
- Monitoruar veprimet e Qeverisë në lidhje me përzgjedhjen e stafit në pozitat kyçe në qeveri dhe se do ta adresojë çështjen e pozitave të ushtruesve të detyrës me kohë; dhe
- Të gjejë një zgjidhje të përshtatshme për sa i përket shërbimeve të auditimit të brendshëm për institucionet e vogla të pavarura, të cilat i raportojnë drejtpërsëdrejti Kuvendit. Kjo do të ruante pavarësinë dhe llogaridhënien. Themelimi i një funksioni të auditimit të brendshëm brenda Kuvendit, i cili do të ofronte shërbime të përbashkëta për institucionet e vogla të pavarura mund të ishte një zgjidhje me kosto efektive.

## **5. Ekzekutimi i buxhetit në Sektorin Publik**

### **5.1 Autoritetet qendrore**

#### **5.1.1 Hyrje**

ZAP ka kryer auditime të rregullsisë të PVF-ve të të gjitha 24 Autoriteteve Qendrore (AQ)<sup>20</sup> për vitin 2013. AQ-të përgatitën Pasqyrat Vjetore Financiare të vitit 2013 në pajtim me kërkesat. Opinionet e dhëna ishin të pamodifikuara, përveç se në 11 raste<sup>21</sup> ato janë me theksim të çështjes sepse informacioni në lidhje me shpalosjet nuk ishte i plotë dhe i saktë. Theksimi i çështjes në tetë prej 11 rasteve kishin të bënin me shpalosjet për pasuritë fikse.

<sup>20</sup> 24 AQ përfshijnë 19 Ministri si dhe Kuvendin, Zyrën e Presidentit, Zyrën e Kryeministrit, Doganën dhe Administratën Tatimore.

<sup>21</sup> Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Ministria e Edukimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Ministria e Shëndetësisë, Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Zyra e Kryeministrit dhe Doganat e Kosovës.

Tabela në vijim paraqet pasqyrën e opinioneve për AQ.

**Tabela 12 Opinionet e auditimit për Autoritetet Qendrore (tre vitet e fundit)**

<b>Opinionet e auditimit</b>	<b>2013</b>	<b>2012</b>	<b>2011</b>
Opinion i pamodifikuar	13	14	13
Opinion i pamodifikuar me Theksim të çështjes	11	10	11
<b>Totali</b>	<b>24</b>	<b>24</b>	<b>24</b>

Marrë parasysh të dhënat nga periudhat e mëhershme të raportimit, AQ-të kanë vendosur sisteme të qëndrueshme të raportimit të jashtëm. Mangësitë kryesisht kanë të bëjnë me shpalosjen e informacionit të caktuar, i cili nuk ka ndikim material në nivel të përgjithshëm në PVF. AQ-të duhet të avancojnë edhe më tutje sistemet e tyre për të siguruar informacion të plotë në lidhje me shpalosjet ku edhe gjendet baza për Theksim të çështjes.

### 5.1.2 Sfidat e hasura

Raportimi i brendshëm dhe linjat e llogaridhënies ndërmjet ministrive dhe agjencive ekzekutive (autonome) që operojnë në kuadër tyre mbetet sfidë e veçantë. Procesi i konsolidimit të PVF-ve shpesh nuk është adekuat për shkak të aranzhimeve joefektive të llogaridhënies. Një shembull i kësaj është procesi i llogaridhënies mes Zyrës së Kryeministrit (ZKM) dhe agjencive të saj. Kryeshefët Ekzekutiv të Agjencive raportojnë tek Zëvendës Kryeministrat për fusha të caktuara të aktivitetit, ndërsa Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës për cilësinë e PVF-ve të konsoliduara dhe punët e përditshme në përgjithësi.

Më tutje, komunikimi dhe raportimi i brendshëm brenda AQ-ve nuk ishte i një niveli të mirë në përgjithësi. Mënyra se si vendimet dhe rezultatet nga takimet e menaxhmentit të lartë ishin dokumentuar lë vend për përmirësim. Praktikrat aktuale të raportimit dhe komunikimit nuk i ofrojnë menaxhmentit informacion të mjaftueshëm (financiar dhe operativ), për të mbështetur vendimmarrjen efektive, mbikëqyrje dhe kërkesat e tjera menaxheriale.

Shkalla e adresimit të rekomandimeve të dhëna nga Auditori i Përgjithshëm për AQ-të është në përmirësim e sipër. Të gjitha AQ-të kanë nxjerrë plane veprimi për adresimin e rekomandimeve të vitit 2012. Nga 363 rekomandime të dhëna, 273 janë adresuar (164 plotësisht dhe 109 në proces të adresimit), ndërsa 90 kanë mbetur të pa adresuara. Rekomandimet e pa adresuar kryesisht kishin të bënin me realizimin e ulët buxhetit dhe mangësitë në menaxhimin e shpenzimeve. Për pasoj, mangësi të ngjashme janë raportuar përsëri në 2013, disa prej të cilave janë mangësi domethënëse në lidhje me kontrollin.

Ekzekutimi i përgjithshëm i buxhetit nga AQ-të ishte 91%. Realizimi më i ultë i buxhetit është parë në MAP me 59%, Ministrinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit (MKRS) dhe ZKM me 78%.

Shumica e mangësive në procesin buxhetor kishin të bënin me proceset e dobëta të planifikimit, nivelin e ulët të ekzekutimit të buxhetit për investime kapitale dhe klasifikimin

e buxhetit në kategori jo adekuate. Çështja e fundit ishte ngritur nga disa AQ në MF nga ku kanë kërkuar transferimin e buxhetit nëpër kategoritë përkatëse, por për këtë nuk ishte bërë asnjë zgjidhje dhe keq klasifikimi ka mbetur si i tillë.

Tek menaxhimi i të hyrave ka vend për përmirësim në disa AQ. Në disa prej tyre mungonte softueri për menaxhimin e të hyrave dhe për pasojë informacioni i gjeneruar në mënyrë manuale nuk ishin në të gjitha rastet i besueshëm. Më tutje, ka pasur raste kur të hyrat ishin regjistruar me vonesë dhe nuk kishte harmonizime të plota mes regjistrave dhe dokumenteve burimore. Vonesat në raportimin e të hyrave në MPJ nga Misionet Diplomatike të Kosovës ka vazhduar të mbetet sfida.

Cilësia e prokurimit publik është një çështje e përgjithshme dhe vazhdon të jetë një nga sfidat më të mëdha të AQ-ve edhe këtë vit. Sfidat janë adresuar në Kapitullin 4, e njëjta gjë është bërë edhe për menaxhimin e burimeve njerëzore dhe auditimin e brendshëm.

Praktika aktuale e menaxhimit dhe kontrollimit të Subvencioneve dhe Transfereve nuk ofron siguri të mjaftueshme nëse ato shfrytëzohen drejt dhe për qëllimet e dedikuara dhe nëse janë arritur rezultatet e planifikuara. Në veçanti, cilësia e kontrolleve në menaxhimin e pensioneve bazë dhe atyre kontribut-dhënëse, subvencioneve në fushën e bujqësisë dhe subvencioneve për integrimin e minoriteteve ishte e mangët. Mekanizmat aktual të raportimit dhe monitorimit të subvencioneve për të justifikuar pagesat e bëra dhe për të vlerësuar nëse objektivat e subvencionimit janë duke u arritur, nuk ishin mjaft efektive.

Përkundër përmirësimeve sistematike, menaxhimi i pasurisë vazhdon të mbetet sfida për AQ-të. Regjistrat kontabël janë të kompletuar në shumicën e institucioneve, megjithatë sfida mbetet kryerja e inventarizimit vjetor, regjistrimi i pasurive në regjistrin e pasurisë dhe raportimi i tyre në PVF. Procesi i kontimit dhe konsolidimit të të dhënave mes Agjencive Ekzekutive apo njësisive vartëse të ministrive nuk është i përshtatshëm. Si pasojë, vlera e pasurisë në regjistra ishte jo e plotë dhe e pa saktë.

Më tutje, edhe kontrollet mbi menaxhimin e detyrimeve ishin jo efikase. Krahasuar me vitin 2012, detyrimet e papaguara të vitit 2013 në AQ janë rritur për 117%. Në këtë përqindje, pjesëmarrjen më të madhe e kishte MASHT, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) dhe Ministria e Infrastrukturës (MI). Hyrja në kontrata pa zotim të mjeteve, zhvillimi i prokurimeve në muajt e fundit të vitit dhe ardhja me vonesë e faturave janë disa nga shkaktarët e rritjes së obligimeve.

Për sa i përket politikave për një ambient të qëndrueshëm, ne kemi audituar mënyrën se si është menaxhuar sistemi i mbeturinave medicinale, ku kemi identifikuar mangësi. Ekziston nevoja që autoritetet të krijojnë një sistem të integruar për trajtimin e mbeturinave. Menaxhimi i mbeturinave duhet të bëhet nga persona kompetent, aktivitetet të kryhen si duhet për të siguruar ruajtjen e shëndetit publik. Niveli i dokumentimit dhe monitorimit të aktiviteteve si dhe bashkëpunimi dhe koordinimi i përsheptuar mes institucioneve shëndetësore duhet të rritet.

Në fushën e ndërtimit të kapaciteteve në administratën publike, ne ekzaminuam Programet Studimore të financuara bashkërisht nga Qeveria dhe donatorët. Në këtë auditim, ne rekomanduam ministritë përgjegjëse që të krijojnë udhëzimet ku do të përshkruheshin hapat të cilat duhet të ndiqen nga të gjitha ministritë përgjegjëse për menaxhimin e programeve studimore të financuara. Secila ministri duhet të vendosë dhe zbatojë obligime kontraktuale për të siguruar se përfituesit, edhe pas përfundimit të programit studimor, do të vazhdojnë të japin kontribut në administratën publike pas përfundimit të bursës ose do të kthejnë fondet nëse obligimet nuk kryhen.

Gjatë ekzaminimit të përdorimit të matur të burimeve, ne adresuam menaxhimin e automjeteve zyrtare dhe analizuam kufizimet në sistemin aktual për autorizimin e përdorimit të automjeteve zyrtare. Ne rekomanduam të implementohen kontrolle efektive të monitorimit për të siguruar shpërndarje dhe shfrytëzim efikas të veturave zyrtare duke u bazuar në nevoja të departamenteve e jo të individëve. Dispozita të raportimit efikas dhe në kohë për shfrytëzimin e automjeteve zyrtare duhet të vihen në zbatim dhe të shërbejnë si bazë për vendimmarrje. Auditimet e kryera staturore tregojnë se sfida të ngjashme ekzistojnë edhe në OB të tjera.

## **Rekomandimet**

### **Unë rekomandoj Qeverinë të sigurojë se:**

- Marrëveshje të zgjeruara të llogaridhënies janë zhvilluar mes Autoriteteve Qendrore dhe agjencive të tyre, të cilat duhet të qartësojnë linjat e llogaridhënies, të ofrojnë struktura efikase të raportimit në mbështetje të një menaxhimi financiar të fuqishëm dhe raportimit dhe vendimmarrjes me kohë. Në këtë aspekt, kjo duhet të mbështesë një proces efektiv të konsolidimit të pasqyrave financiare;
- Politikat buxhetore, veçanërisht në planin e investimeve kapitale janë përmirësuar dhe se kontrollet financiare lidhur me regjistrimin e shpenzimeve në kategoritë adekuate ekonomike janë forcuar;
- Një kornizë të qartë të menaxhimit të rrezikut në lidhje me objektivat organizative është futur në përdorim. Kjo duhet të përdoret si një bazë për forcimin dhe zhvillimin e një mjedisi të përshtatshëm dhe efektiv të kontrollit dhe si pikënisje për punën e auditimit të brendshëm; dhe
- Vlerësimi i efektivitetit të kornizës ligjore aktuale dhe praktikave për përdorimin e veturave zyrtare ka filluar.

### **Unë rekomandoj Kuvendin që të marrë parasysh:**

- Se me rastin e ndarjeve buxhetore të ketë në konsideratë performancën buxhetore të Autoriteteve Qendrore për vitin paraprak, t'i diskutojë arsyet për suficitet dhe më pas të marrë vendimet e duhura për ndarjet vjetore të buxhetit.

## 5.2 Institucionet e pavarura

### 5.2.1 Hyrje

Për vitin 2013, ne kryem auditime të rregullsisë për PVF-të e hartuara në 26 Institucione të Pavarura (IP). Niveli i pajtueshmërisë me kërkesat për raportim është i mirë. Në shumicën e IP-ve, PVF-të kanë paraqitur një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.

**Tabela 13: Opinionet e auditimit të dhëna gjatë tri viteve të fundit**

Opinionet e auditimit	2013	2012	2011
I pamodifikuar	20	18	18
I pamodifikuar me theksim të çështjeve	4	6	7
I kualifikuar	2	2	1
I kualifikuar me theksim të çështjeve	1	1	
<b>Gjithsej:</b>	<b>27<sup>22</sup></b>	<b>27</b>	<b>26</b>

Përrjashtim nga kjo bëjnë tre raste<sup>23</sup>, në të cilat ne kemi dhënë opinione të kualifikuara për shkak të mangësive në raportimin e të të hyrave si dhe ekzekutimit të pagesave të cilat nuk janë realizuar në pajtueshmëri me legjislacionin. Në katër raste<sup>24</sup> ne theksuam çështjet për shkak të mangësive në shpalosjen e informacionit për pasuritë.

Procesi i raportimit, në raport me vitet e kaluara, është zhvilluar dukshëm. Tani, Kuvendi ka informata pothuajse të gjithë informacionin që i nevojitet aktualisht lidhur me menaxhimin e buxhetit të IP-ve. Pjesa me e madhe e tyre kanë përmbushur të gjitha kërkesat ligjore për raportimin e jashtëm.

Buxheti fillestar për 26 IP-të e audituara nga ZAP-i për vitin 2013 ishte 87,791,452€, ndërsa buxheti final 86,528,364€. Shpenzimi vjetor ishte 76,477,053€ ose 88% e buxhetit final, me një përmirësim prej 5% në raport me vitin 2012.

IP-të në përgjithësi kanë treguar përkushtimin e tyre për të përmirësuar menaxhimin e financave publike dhe kontrollet. Megjithatë, nevojiten veprime shtesë për të adresuar të gjitha çështjet e dala nga auditimi. Më tutje, Zyra Koordinuese e Kuvendit ka filluar të adresojë rekomandimin tonë të dhënë lidhur me shqyrtimin e mundësive për vendosjen e kërkesave të reja raportuese dhe integrimin e raportimit financiar me atë operativ në një raport të vetëm. Kjo duhet të hapë rrugën për një dialog më të avansuar për buxhetin dhe ekzekutimin e tij. Ne ende identifikuam disa sfida me të cilat përballen IP-të, të cilat janë prezantuar si në vijim.

<sup>22</sup> ZAP në kuadër të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP), përpos PVF-ve ka audituar edhe Fondin e Mirëbesimit. Në këtë raport janë dhënë dy opinione të auditimit brenda një raporti. Si rezultat e kësaj numri i opinionëve të dhëna është me i madh se numri i agjencive të audituara.

<sup>23</sup> AKP, Fondi i Privatizimit dhe Organi Shqyrtues i Prokurimit.

<sup>24</sup> Universiteti i Prishtinës, Zyra Rregullative e Energjisë, Prokurori i Shtetit, dhe Komisioni Rregullativ për Prokurim Publik

## 5.2.2 Sidat e hasura

Tek menaxhimi i të hyrave ekzistojnë dobësi në inkasimin e tyre dhe mungon harmonizimi mes regjistrave dhe dokumenteve burimore. Në raste të caktuara, inkasimi i të hyrave nuk është bërë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Fushat më sfiduese edhe gjatë vitit 2013, si çdokund, mbeten fusha e prokurimit e ndjekur nga ajo e menaxhimit të burimeve njerëzore. Sfidat janë përshkruar në Kapitullin 4.

Në fushën e fundit, situata më e shpeshtë është se shumë pozita menaxheriale ishin mbuluar me staf ushtrues të detyrës për një kohë më të gjatë se sa lejohet me ligj.

Te menaxhimi i pasurive vërehen përmirësime të dukshme në krahasim me vitin e kaluar. Gjatë vitit 2013, disa institucione i kishin kompletuar regjistrat kontabël, por ende ka mangësi në regjistrimin dhe raportimin e pasurive në disa IP.

### Koordinimi ndërinstytucional

Megenëse shumica e IP-ve janë institucione me buxhet të vogël dhe stafi i tyre kryesisht është profesional, ata duhet të gjejnë zgjidhje tjera për të mbuluar kërkesat e përgjithshme. Më shumë rezultate do të mund të arriheshin me më pak fonde përmes një bashkërendimi dhe bashkëpunimi më të mirë mes IP-ve. Megjithatë, shumë pak është bërë në këtë drejtim në vitin 2013. Bashkëpunimi ishte zhvilluar kryesisht në fushën e prokurimit.

NJAB te shumica e IP-ve nuk ishte themeluar pasi kjo nuk është një kërkesë për OB-të e vogla. Duke marrë parasysh se në një numër rastesh, shërbimet e auditimit të brendshëm do të ishin të nevojshme për menaxherët, IP-të duhet të gjejnë një mënyrë për ti ndarë së bashku këto shërbime.

Bashkëpunimi mes IP-ve, për mbështetje të përbashkët është i nevojshëm për të mbështetur arritjen e objektivave strategjike institucionale. Shembull për këtë janë institucionet e sistemit të gjyqësorit<sup>25</sup> si dhe Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale me institucionet tjera në mbështetje të zbatimit të ligjit për miniera dhe minerale<sup>26</sup>.

### Hapësirat për punë

Hapësirat për punë shpesh janë të pamjaftueshme dhe nuk ofrojnë standarde themelore për punë. Nga 26 IP-të e audituara, 20<sup>27</sup> prej tyre janë të vendosura në objekte private. Vlera e përgjithshme e paguar për qira për vitin 2013 ishte 1,620,817€. Si pasojë e kësaj, një pjesë e konsiderueshme e buxhetit vazhdon të shpenzohet për qira, në vend se ato të shpenzohen për aktivitete tjera operative dhe profesionale.

### Pavarësia nga emërimi dhe plotësimi i pozitave të larta publike

Në dhjetor të vitit 2012 në kuadër të Kuvendit është themeluar një pikë kontakti e përhershme për IP-të për të njoftuar komisionet e Kuvendit për skadimin e mandatave të bordeve dhe anëtarëve të tyre. Kjo ka ndihmuar komisionet relevante të përgatisin proceset

<sup>25</sup> Bashkëpunimi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Institutit Gjyqësor të Kosovës, Prokurorit të Shtetit dhe Ministrisë së Drejtësisë.

<sup>26</sup> Bashkëpunimi mes KPMM me prokuroritë, Ministrinë e Punëve të Brendshme(MPB), MMPH dhe Komunave

<sup>27</sup> Në fund të vitit 2013 Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (ASHMDHP) kishte kaluar në objekte publike.

e emërimit para skadimit të mandateve. Përkundër kësaj, gjatë vitit 2013 katër IP<sup>28</sup> nuk i kishin të kompletuara bordet, duke rezultuar në funksionalitet të dobët bordeve gjatë një periudhe të caktuar.

## Rekomandimet

### Unë rekomandoj Kuvendin të konsiderojë:

- Marrjen e menjëhershme të masave për emërimin brenda afateve ligjore pas njoftimit lidhur me skadimin e mandateve të bordeve dhe anëtarëve të tyre;
- Promovimin e mëtejshëm të bashkëpunimit horizontal mes Institucioneve të Pavarura përmes Zyrës Koordinuese të Kuvendit për shkëmbimin e njohurive dhe shfrytëzimin sa më racional të resurseve njerëzore;
- Të këshillojë Qeverinë që të shqyrtojë mundësitë për ti ofruar Institucioneve të Pavarura hapësira për punë në objekte publike brenda një periudhe sa më të shkurtër të mundshme, duke reduktuar dukshëm shpenzimet operative të IP-ve; dhe
- Hartimin e kornizës për raportim në mënyrë që të sigurojë krijimin e mekanizmave të fortë për llogaridhënie nga IP-të për paranë publike të shpenzuar dhe rezultatet e arritura.

## 5.3 Komunat

### 5.3.1 Hyrje

Ne kemi kryer auditimin e rregullsisë të PVF-ve të të gjitha 38 komunave<sup>29</sup> për vitin 2013. Nga këto, auditimi i 11 prej tyre është kontraktuar tek një kompani ndërkombëtare private e auditimit.

Opinione të Pamodifikuara janë dhënë për 33 komuna, prej të cilave 31 me theksim të çështjes. Opinione të Kualifikuara me theksim të çështjes janë dhënë për tre komuna, ndërsa Mohim Opinioni është dhënë për dy.

**Tabela 14: Ndryshimet e opinioneve për auditimet e komunave në tri vitet e fundit**

Opinionet e auditimit	Viti 2013	Viti 2012	Viti 2011
Të pamodifikuara	2	5	2
Të pamodifikuara me theksim të çështjes	31	25	14
Të kualifikuara me theksim të çështjes	3	5	18
Mohim i opinionit	2	3	3
<b>Totali:</b>	<b>38</b>	<b>38</b>	<b>37</b>

## Vetëqeverisja lokale dhe përgjegjësitë

Burimet financiare të komunave përbëhen nga grantet nga niveli qendror, grantet operative dhe grantet për kompetencat e zgjeruara<sup>30</sup> dhe grantet e jashtëzakonshme si dhe nga të hyrat

<sup>28</sup> Autoriteti Kosovar i Konkurrencës, Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturorë, Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik si dhe AKP.

<sup>29</sup> Këtu është përfshirë edhe Zyra Administrative në Mitrovicën Veriore

nga tatimet dhe përfitimet nga huadhëniet komunale. Përveç kësaj, donatorë të ndryshëm japin mbështetje ndaj projekteve dhe komunat me shumicë serbe marrin ndihma financiare nga Republika e Serbisë. Në këto raste gjendja e auditimit nuk është mjaft transparente.

### **Qarkullimi në komuna**

Shpenzimet totale të komunave për vitin 2013 ishin 386,068,502€<sup>31</sup> apo 26% e shpenzimeve totale të BK-së. Gjatë vitit 2013, Komunitat kishin inkasuar 55,850,331€ të hyra vetanake që përbënin vetëm 14% të strukturës së përgjithshme të financimit. Krahasuar me vitin 2012, të hyrat vetjake janë zvogëluar për 6%. Buxheti final i komunave ishte shpenzuar në shkallën mesatare prej 90% krahasuar me 89% në vitin 2012.

### **5.3.2 Sfidat e hasura**

#### **Zbatimi i rekomandimeve nga viti i kaluar**

Veprimet e marra për rekomandimet tona nuk ishin të kënaqshme. Në raportet e nxjerra për vitin 2012 ne kemi dhënë 425 rekomandime për 35 komuna<sup>32</sup>. Nga këto, vetëm 52% ishin adresuar plotësisht ose pjesërisht.

Për më tepër, tre komuna nuk kishin përgatitur Planin e Veprimit për adresimin e rekomandimeve<sup>33</sup> të dhëna.

#### **Pajtueshmëria me kërkesat e raportimit financiar**

Krahasuar me PVF-të e vitit 2012, zbatimi i kërkesave ligjore për raportim financiar ka shënuar përmirësim të ndjeshëm. Vetëm një numër i vogël i komunave nuk kanë plotësuar disa nga kërkesat ligjore mbi raportimin financiar. Në vazhdim po paraqesim çështjet kyçe:

- Zubin Potoku nuk i ka dorëzuar PVF në Thesar, ndërsa tre të tjera (Leposaviqi Parteshi dhe Zveçani) kanë pasur mangësi në nënshkrimin dhe vulosjen e Deklaratës nga personat e autorizuar; dhe
- Katër komuna nuk i kanë përgatitur PVF në të dy gjuhët.

Me ndihmën e ZAP-it, Leposaviqi dhe Zveçani për herë të parë kanë hartuar PVF dhe kanë ofruar një bashkëpunim të plotë në auditim. Megjithatë, ato vazhdojnë të përballen edhe me sfida tjera, siç janë: mungesa e trajnimeve të duhura profesionale, sidomos në qasjen e përdorimit të moduleve të SIMFK, adresimin e kërkesave të MF/K-së (metodat për hartimin e buxheteve vjetore, zbatimin e rregulloreve të prokurimit etj) dhe krijimi i strukturave të qëndrueshme organizative.

---

<sup>30</sup> Llojet e kompetencave të zgjeruara në mënyrë të detajuar janë përshkruar në nenet 19-23 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, ndërsa buxhetimi për kompetenca të zgjeruara është përshkruar në nenin 6 të Ligjit për financat e pushtetit lokal nr. 03/L-049.

<sup>31</sup> Në vitin 2012 ishin shpenzuar 367,296,565€.

<sup>32</sup> Duke përjashtuar Leposaviqin, Zubin Potokun dhe Zveçanin.

<sup>33</sup> Komuna e Gjakovës, Istogut dhe Kllokotit.

### Zhvillimi i indikatorëve të performancës

Përveç auditimit të rregullsisë, ne kemi analizuar edhe disa indikatorë kyç potencial të performancës së komunave dhe lidhur me këta indikatorë është duke publikuar një raport i veçantë për diskutim. Rezultatet e kësaj analize kanë nxjerrë në pah disa sfida kryesore me të cilat komunat përballen aktualisht, ku përfshihen:

- (a) *Menaxhimi i dobët i detyrimeve të pa paguara.* 34 komuna, duke i përjashtuar katër komunat e veriut për të cilat ne nuk i posedojmë të dhënat e plota, kanë detyrime mbi 46 milionë euro, nga të cilat 16 milionë janë të vitit 2013, dhe pjesa tjetër për vitet e mëparshme.
- (b) *Rritja e vazhdueshme e borxheve të pa mbledhura ndaj komunave.* Gjendja e llogarive të pa mbledhura në fund të vitit 2013 kap një shumë prej 147 milionë euro. Pjesa më e madhe e këtyre borxheve ka të bëjë me tatimin në pronë (104 milionë euro), tarifatat e bizneseve, lejet e ndërtimit dhe qiratë. Komunat nuk kanë ndonjë strategji si t'i qasen adresimit të këtyre borxheve historike.
- (c) *Planifikimi i dobët i të hyrave.* Me rastin e planifikimit vjetor të të hyrave, nuk ka konsistencë në mes shumave të planifikuara, të faturuara dhe atyre të mbledhura. P.sh me rastin e caktimit të ngarkesave të tatimit në pronë, planifikimi nuk ndërlidhet me faturimet e as me trendin e inkasimeve në vitet paraprake.
- (d) *Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve nëpër kode ekonomike.* Në shumicën e komunave disa shpenzimeve nuk ishin në pajtim me ndarjet fillestare buxhetore. P.sh. në mungesë të fondeve, fondet e ndara për investime kapitale ishin shpenzuar për mallra dhe shërbime. Komunat nuk kanë përdorur opsionin e transferimit të buxhetit (brenda kufijve të caktuar) nga një kategori në kategorinë tjetër ekonomike.
- (e) *Mungesa e nikoqirllëkut në administrimin e shpenzimeve.* Disa komuna<sup>34</sup> kanë krijuar shpenzime jo racionale të udhëtimit, reprezentacionit, blerjen dhe përdorimin e veturave luksoze. Në disa janë vërejtur shpenzime shumë të larta të reprezentacionit.

### Gjetjet kyçe të auditimit

Ne kemi vërejtur dobësi në disa fusha shumica e të cilave janë raportuar në vitin 2012 dhe më parë:

- Mos adresimi i rekomandimeve të auditimit të dhëna nga Auditori i Përgjithshëm;
- Mos prezantim i drejt në PVF i pagesave nga palët e treta;
- Nivel i ulët i ekzekutimit të buxhetit tek kategoria investime kapitale;
- Në shumë komuna vazhdon të ketë kontrolle të brendshme të pa mjaftueshme në sistemin e prokurimit;
- Mungesa e kontrolleve përgjatë mbikëqyrjes së kontratave të investimeve kapitale dhe vonesa në realizimin e kontratave;
- Dhënia e subvencioneve pasur parasysht rregulloret e brendshme komunale dhe mungesë e informacioneve kthyesë nga ana e përfutuesve për mënyrën e shfrytëzimit të subvencionit;

<sup>34</sup> Gjilan, Gjakovë, Graçanica, Kamenica, Mitrovica, Peja, Skënderaj

- Regjistrat e pasurive jo të plotë, vonesa në inventarizimin e pasurisë dhe mos shpallje e duhur e informatave në PVF;
- Mosfunksionimi i KA-ve në pothuajse gjysmën e komunave ka rezultuar në një sistem jo efikas të auditimit të brendshëm nëpër komuna; dhe
- Në shumicën e komunave menaxhmenti kishte adresuar vetëm rekomandimet e dhëna nga NJAB deri në një masë të kufizuar.

Shumë nga mangësitë e kontrollit të brendshëm të renditura më sipër lidhen me mungesën e një softueri të përgjithshëm të raportimit të brendshëm që lejon regjistrimin më të mirë të informacionit të biznesit si një bazë për vendimet e mëtejshme e menaxhmentit. Një sistem i tillë do të ndihmonte transparencën dhe lehtësonte zhvillimin e indikatorëve në bazë të cilëve mund të bëhen krahasimet mes komunave.

## Rekomandimet

### Unë rekomandoj Qeverinë të sigurojë që:

- Ministri i Financave të diskutojë me kryetarët e komunave çështjen e detyrimeve të papaguara, dhe të rishikojë alternativat për shlyerjen e këtyre detyrimeve;
- Ministri i Financave të iniciojë një diskutim gjithëpërfshirës me Kryetarët e komunave dhe Qeverinë lidhur me trajtimin e borxheve të pa mbledhura, me fokus të veçantë borxhet më të vjetra se pesë vite;
- Të analizojë mundësitë për të investuar në një sistem të përgjithshëm për raportim të brendshëm të komunave në mënyrë që të mbështesë një kontroll më të mirë mbi aktivitetet e komunave;
- Të nxjerrë rregullore të qarta ku do të specifikoheshin qartë tavanet e lejuara të shpenzimeve të reprezentacionit nëpër komuna; dhe
- Të intensifikojë diskutimet me Kryetarët e komunave veriore për të identifikuar sfidat me të cilat ato përballen dhe të ofroj mbështetjen e duhur për integrimin e tyre të plotë në të gjitha fushat. Më tutje, të përcaktojë mënyrat e ofrimit të trajnimeve të duhura për përdorimin e moduleve të SIMFK dhe funksionet e tjera të nevojshme në Menaxhimin e Financave Publike.

### Unë rekomandoj Kuvendet Komunale të sigurojnë se:

- Me rastin e shqyrtimeve të raporteve tremujore të buxhetit, në fokus të veçantë të kenë trajtimin e detyrimeve dhe borxheve të pa mbledhura;
- Para dorëzimit të kërkesave buxhetore për vitin 2015, të shqyrtojnë raportet e auditimit, me fokus të veçantë adresimin e rekomandimeve dhe eliminimin e mangësive të identifikuara; dhe
- Të themelojnë Komitetet e Auditimit të Brendshëm aty ku ato nuk janë ende të themeluara.

### Unë rekomandoj Kuvendin që të konsiderojë:

Adresimin e rekomandimit nga viti i kaluar për ri-vendosjen e funksionit Menaxher Ekzekutiv në të gjitha komunat, si nëpunës më i lartë civil në administratë, përgjegjës për ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve.

## 5.4 Ndërmarrjet Publike dhe Shoqërore

### 5.4.1. Hyrje

NP-të<sup>35</sup> janë në pronësi të shtetit. NP-të kategorizohen si:

- NP Qendrore dhe Rajonale; dhe
- NP Lokale.

Ndërmarrjet Publike Qendrore dhe Regjionale mbikëqyren dhe monitorohen direkt nga Ministria për Zhvillim Ekonomik si përfaqësues i pronarit. NP-të lokale janë në pronësi të Komunës apo në disa raste të një numri komunash së bashku. Secila Komunë është e obliguar të nxjerrë një politikë të pronësisë e cila i paraqet objektivat e përgjithshme të komunës në lidhje me pronësinë e NP-së Lokale si dhe rolin e saj në qeverisjen e përbashkët të tyre. Bordet e Drejtorëve (BD) janë të obliguar të mbikëqyrin punën e menaxhmentit në mënyrë që të arrihen objektivat dhe NP-të të japin rezultate. Komunitat ushtrojnë të drejtat e aksionarit Komisioni Komunal i Aksionarëve (KKA). Ndërmarrjet Shoqërore (NSH-të) përfaqësohen nga AKP. Funkzioni i AKP-së është administrimi dhe privatizimi i NSh-ve dhe aseteve të tyre<sup>36</sup>.

### 5.4.2 Ndërmarrjet Publike

Për vitin financiar 2012, ne publikuam pesë raporte auditimi<sup>37</sup> për 5 entitete të audituara, të cilat rezultuan me gjithsej 18 rekomandime. Nga këto, gjashtë rekomandimet e mëposhtme iu janë dhënë Qeverisë dhe Kuvendit. Entitetet e audituara kishin hartuar planet e veprimit për adresimin e rekomandimeve të dhëna.

#### **Rekomandimet e vitit të kaluar për Qeverinë ishin:**

- Krijimi i forumeve në mes të Qeverisë dhe të ndërmarrjeve për të diskutuar sfidat me të cilat përballen dhe mundësitë për të përmirësuar performancën dhe shërbimet;
- Përfshirja e një shkalle më të lartë të informacionit mbi performancën e NP-ve dhe kontributin e tyre në përmbushjen e objektivave të caktuara në raportin e lëshuar nga Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike (NJPM/NP) në kuadër të Ministrisë për Zhvillim Ekonomik (MED) për operimet e NP-ve;
- Shkallë më të lartë të bashkëpunimit ndërmjet ministrive në lidhje me zbatimin e politikave dhe fushave të ndryshme të politikës; dhe
- Se NJPM/NP kryen përcjellje të rregullt se si NP-të adresojnë rekomandimet e dhëna nga Auditori i Përgjithshëm.

<sup>35</sup> Në total ekzistojnë 61 NP, nga të cilat 17 janë qendrore dhe 44 janë lokale.

<sup>36</sup> Ky autorizim përfshinë autorizimin për shitje, transfer dhe likuidim të ndërmarrjeve dhe aseteve të tyre.

<sup>37</sup> Nga të cilat 4 ishin auditime jo statutorë dhe 1 auditim menaxherial

**Rekomandimet e vitit të kaluar për Kuvendin ishin që të merrte parasysh që:**

- Në mënyrë aktive të përcjell veprimet e Qeverisë duke shikuar performancën e NP-ve në lidhje me politikat e vendosura për ofrimin e shërbimeve cilësore për qytetarët, si dhe sfidat me të cilat përballen në këtë proces; dhe
- Informata prapavajtëse ti ofrohen NJPM /NP mbi përmbajtjen e analizës së performancës së NP-ve, të përfshijë edhe informatë jo vetëm me performancën operacionale dhe financiare, por edhe analizën e mangësive në ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve.

**A. Sfidat me të cilat ballafaqohen NP-të qendrore**

Këtë vit ne kemi vërejtur që NJPM /NP ka filluar zhvillimin e një formati të standardizuar të kriterëve vlerësuese të cilat do të përdoren për të hartuar raportin e performancës së NP-ve. Gjithashtu NJPM /NP ka përcjellur nivelin e adresimit të rekomandimeve bazuar në planet e veprimit të NP-ve dhe kanë diskutuar rekomandimet me NP-të e audituara në takimin vjetor të mbajtur midis Qeverisë së pronar dhe NP-ve.

Sidoqoftë, ne nuk kemi informata që janë themeluar forumet ndërmjet qeverisë dhe NP-ve për të diskutuar sfidat, apo që është ngritur niveli i bashkëpunimit ndërmjet ministrive rreth implementimit të politikave që kanë të bëjnë me NP-të.

Kuvendi po ashtu nuk ka pasur ndonjë rol aktiv sa i përket rekomandimeve për NP-të pasi që nuk kishin organizuar asnjë sesion dëgjimi për raportet e hartuara, dhe asnjë kërkesë për informata specifike nuk ishte bërë ndaj Qeverisë.

Auditimet e performancës të këtij viti për BD-të në NP-të qendrore kanë identifikuar dobësitë si në vijim:

- MZHE – NJPM/NP si përfaqësuese e aksionarit në raport me NP-të nuk ka siguruar monitorim efektiv të BD-ve;
- KA-të e NP-ve nuk kanë vendosur kriterë plotë e të matshme për caktimin e kompensimit të anëtarëve të BD-ve; dhe
- Në disa raste BD-të e NP-ve kanë tejkaluar deri në 100% tarifën e paraparë të honorarit bazë duke pranuar kompensime për pjesëmarrje në numër të madh të komisioneve, të cilat mund të kenë pasur efekt në efikasitetin e punës së tyre;

**Rekomandimet****Unë rekomandoj Qeverinë që të sigurojë që:**

- Se janë hartuar dispozitat të cilat qartë përcaktojnë dhe përshkruajnë procesin si dhe afatet kohore për përzgjedhjen e Bordit të Drejtorëve;
- Procedura e përzgjedhjes së Bordit të Drejtorëve në Ndërmarrjeve Publike kryhet sipas afateve të përcaktuara në dispozita;
- Vlerësimi i Bordit të Drejtorëve bazohet në kriteret e përcaktuara më parë;

- Ministria e Zhvillimit Ekonomik kryen analiza të pasqyrave financiare të Ndërmarrjeve Publike dhe specifikon informacionet standarde të nevojshme për monitorim dhe mbikëqyrje efektive; dhe
- Ministria e Zhvillimit Ekonomik ka ndërmarrë masa për të siguruar se kompensimet e Bordit të Drejtorëve bazohen në rezultate.

#### **Unë rekomandoj Kuvendin që konsiderojë:**

- Përcjelljen nga afër të mënyrës se si Qeveria zbaton përgjegjësitë e saj si pronar në lidhje me Ndërmarrjet Publike qendrore, duke u fokusuar në indikatorët e performancës; dhe
- Rritjen e fokusit në mbikëqyrjen e Ndërmarrjeve Publike.

#### **B. Sfidat me të cilat ballafaqohen NP-të lokale**

Në auditimin që ne kemi ndërmarrë në këtë vit lidhur me menaxhimin e mbeturinave, ne kemi identifikuar disa mangësi dhe sfida kryesore me të cilat ballafaqohen aksionarët, MMPH, komunat dhe Kompanitë Regjionale të Mbeturinave (KRM-të) në lidhje me shërbimet e mbeturinave, në veçanti:

- **MMPH** nuk ka hartuar një kornizë gjithëpërfshirëse ligjore për adresimin e menaxhimit të mbeturinave dhe koordinimi me komunat për të trajtuar problemet me mbeturina është i kufizuar;
- **Komunat** kanë mungesë të qartë të përcaktimit të përgjegjësiave të brendshme për administrimin dhe menaxhimin e mbeturinave. Ato po ashtu kanë mungesë të koordinimit dhe komunikimit me MMPH-në për adresimin e mangësive dhe sfidave; dhe
- KRM-të ofrojnë shërbime të kufizuara veçanërisht në zonat rurale ku shërbimet e grumbullimit të mbeturinave ofrohen vetëm në 61% të territorit. Niveli i ulët i inkasimit të të hyrave të faturuara po ashtu është një sfidë e madhe për investimin në cilësinë e operimeve të KRM-ve.

#### **Rekomandimet**

##### **Unë rekomandoj Qeverinë të sigurojë se:**

- Do të vendosen mekanizma më efektiv për t'i qartësuar kërkesat nga strategjia e përgjithshme kombëtare për administrimin e mbeturinave;
- Strategjia kombëtare duhet të azhurnohet rregullisht në mënyrë që të fokusohet në minimizimin dhe parandalimin e mbeturinave;
- Programi ekzistues për inspektim qendror të mbeturinave është implementuar për të adresuar dobësitë në inspektimet e nivelit lokal; dhe
- Të implementojë monitorim dhe raportim efektiv për ambientin duke ofruar informacion gjithëpërfshirës sasior dhe cilësor lidhur me çështjet e menaxhimit të mbeturinave në Kosovë.

**Unë rekomandoj Kryetarët e Komunave të sigurojnë që:**

- Ta përmirësojnë organizimin komunal për mbledhjen e mbeturinave duke i qartësuar përgjegjësitë brenda komunës si dhe të sigurojnë se inspektorët lokal zbatojnë plotësisht programin e punës në mënyrë që të mbështesin një ambient më të pastër;
- Ta shpejtojnë kompletimin e infrastrukturës ligjore mbi mbeturinat komunale përmes nxjerrjes së standardeve dhe rregullave vendore. Për shembull, kjo duhet të siguroj lokacionet adekuate për kontenjerë dhe ta stimulojë ndarjen dhe klasifikimin e mbeturinave; dhe
- Të përkrahen Kompanitë Regjionale të Mbeturinave në promovimin e shërbimeve të grumbullimit të mbeturinave sa i përket zgjerimit të aktiviteteve të tyre dhe në të njëjtën kohë të fokusohen në inkasimin më efektiv të të hyrave, në mënyrë që të gjenerojnë fonde për t'i mbështetur investimet për përmirësimet operationale.

**5.4.3 Ndërmarrjet Shoqërore**

Vitin e kaluar ne ndërmorëm një auditim statutor të rregullsisë në dy pjesët e Trepçës, të cilat rezultuan me gjithsej 45 rekomandime për Trepçën dhe AKP-në si administrator direkt. Këto rekomandime janë dhënë me qëllim të përmirësimit të performancës së NSH-së.

Në RVA-në e vitit të kaluar, unë kam rekomanduar Kuvendin që:

- Të kërkojë nga Bordi i AKP-së që të ofroj rregulla të qarta mbi mënyrën e administrimit, bashkëpunim të duhur mes menaxherëve të Trepçës, shtrin autoritetin në të gjithë ndërmarrjen dhe siguron procesin e duhur të riorganizimit të NSH Trepça.
- Të kërkojë nga Bordi i AKP-së që Menaxherët e Trepçës do të hartojnë PVF-të e unifikuara që përmbajnë informacion të plotë, siç kërkohet sipas ligjit dhe SNRF, ndërsa Bordi i AKP-së të përcjellë bashkëpunimin e tyre; dhe
- Të sigurojë që Menaxherët e Trepçës ofrojnë një ambient adekuat të kontroleve mbi aktivitetet e tyre të biznesit, në mënyrë që të eliminohen dobësitë dhe ato të jenë të orientuara drejt bashkëpunimit adekuat. Duhet të ketë funksionim dhe kontrole të brendshme të unifikuara, si dhe raportet e rregullta financiare të AKP-së duhet gjithashtu të jenë të unifikuara dhe transparente.

Në vitin 2013, AKP kishte punuar ngushtë me Trepçën dhe janë duke vazhduar të implementojnë rekomandimet e vitit të kaluar.

**Rekomandimet****Unë rekomandoj Kuvendin që të konsiderojë:**

- Përcjelljen e progresit të implementimit të rekomandimeve të dhënë për 2012 në lidhje me Trepçën.

## 5.5 Privatizimi

### 5.5.1 Hyrje

AKP-ja është një organ i pavarur publik përgjegjës për implementimin e programin e privatizimeve. Rezultatet e privatizimeve të NSH-ve do të kenë një ndikim potencialisht të madh mbi ristrukturimin e tregut të Kosovës dhe zhvillimin ekonomik, si dhe ngritjen e mirëqenies për qytetarët. Mandati i AKP-së pritet të përfundojë në vitin 2016, pas përmbushjes së objektivave të saj.

Privatizimi i NSH-ve që kanë biznes të qëndrueshëm bëhet në përputhje me ligjin dhe politikat operative të Agjencisë përmes metodës së spin-off-it. Likuidimet vullnetare lejojnë një dalje të shpejtë nga tregu për ato ndërmarrje të cilat nuk kanë perspektivë për të vazhduar me aktivitetet biznesore. Ky proces është i rëndësishëm për të ruajtur vlerën e ndërmarrjeve, dhe në interes të ndonjë pretenduesi për pronësi apo si kreditor.

Në RVA-në e vitit të kaluar ne kemi identifikuar një sërë sfidash për AKP-në, dhe kemi dhënë rekomandime për qeverinë dhe çështje për t'u konsideruar nga Kuvendi. Ne kemi vërejtur që shumica e çështjeve të ngritura kanë mbetur të njëjta.

### 5.5.2 Sfidat e hasura

- Vonesa në procesin e privatizimit dhe likuidimit për shkak të BD-ve të pakompletuara;
- Kontrollë të pamjaftueshme në shpërndarjen e 20% të punëtorët nga shitja e NSH-së;
- Përdorimi i fondeve të NSH-së në likuidim për shërbimet administrative të AKP-së para realizimit të likuidimit të NSH-së;
- Thjeshtësimi i pasqyrave financiare dhe bërja e tyre transparente dhe të lexueshme për lexuesit e jashtëm; dhe
- Përmbushja e objektivave të përfundimit të mandatit të saj deri më 2016.

Në vitin 2013, AKP ka punuar për thjeshtësimin e pasqyrave, rezultatet e të cilave do të shohim në pasqyrat e vitit 2014.

### Rekomandimet

#### Unë Rekomandoj Qeverinë të sigurojë se:

- Të ofroj një procedurë për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordeve të Drejtorë e cila në mënyrë të qartë do të parashihte reklamimin e pozitive, zhvillimin e një procesi të vlerësimit të kandidatëve dhe dorëzimin e propozimeve për kandidatët për emërim në Kuvend.

**Unë rekomandoj Kuvendin të konsiderojë:**

- Zhvillimin e dispozitave të qarta që përcaktojnë oraret për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Drejtorëve, duke mos lënë zbrazësi në funksionimin e Agjencisë;
- Marrjen e masave të cilat sigurojnë se të hyrat nga shitja, transferi dhe likuidimi i NSH-ve, përveç fondeve tepricë, do të mbahet në mirëbesim për pronarët dhe kreditorët; dhe
- Të kërkojë nga Bordi i Drejtorëve të AKP-së qartësi rreth asaj se si duhet të buxhetohet kostoja për shërbimet e likuidimit.

## 5.6 Partneritetet Publiko Private

### 5.6.1 Hyrje

Në këtë sezon jemi angazhuar për herë të parë në auditimin e Partneriteteve Publiko-Private. Qëllimi ishte të identifikohen mangësitë e mundshme dhe sfidave me të cilat mund të ballafaqohen PPP-të, të cilat mund të përdoren si mësim të mësuara për projektet e ardhshme.

### 5.6.2. Sfidat e hasura

Sfidat që ne i kemi vërejtur në implementimin e terminalit të ri Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës 'Adem Jashari' (ANP) janë se:

- Qeveria ka dështuar të adresojë mangësitë e identifikuara gjatë implementimit të projektit. Ata nuk kishin siguruar lejen ndërtimore për ndërtimin e terminalit të ri. Çështjet sa i përket disa pronave të planifikuara për shfrytëzim nga Partneri Privat nuk është zgjidhur ende për shkak të kontestit me KFOR-in; dhe
- Menaxhimi i projektit kishte dobësi për shkak të dështimit të qeverisë për të themeluar një njësi të përhershme dhe profesionale për menaxhimin e projektit. Komisioni i PPP-ve ka mbajtur takime të parregullta, dhe raportet nga inxhinieri i pavarur (IP) ishin jo të plota.

## Rekomandimet

Unë rekomandoj Qeverinë të sigurojë se, gjatë planifikimit të projekteve PPP:

- Të gjitha procedurat administrative respektohen me rastin e nxjerrjes së direktivave, rregulloreve dhe mbajtjes së mbledhjeve;
- Të krijohet një njësi e përhershme për menaxhimin e projekteve. Krijimi i njesisë së pavarur duhet të bëhet parakusht për hyrjen në fuqi të çdo marrëveshje të bërë;
- Komisioni i PPP-ve qartëson afatet kohore të raportimit përmes direktivave dhe rregulloreve dhe, në të ardhmen, të sigurojë raporte me kohë dhe në përputhje me kërkesat e parashkruara; dhe

- Të gjitha dokumentet zyrtare dhe marrëveshjet janë në dispozicion në gjuhët zyrtare të vendit.

**Për përfundimin e projektit aktual të PPP-së, unë rekomandoj që Qeveria të sigurojë që:**

- Çështja e mungesës së lejes së ndërtimit për Terminalin e ri të trajtohet seriozisht dhe akterët përgjegjës të mobilizohen për të legalizuar ndërtesën;
- Të ndërmerren veprime të menjëhershme në lidhje me çështjen e pronës së kontestuar me KFOR-in për të sqaruar kontestin dhe të mbyllen çështjet e pazgjidhura sa i përket shpronësimeve të pronave private në mënyrë që të përfundohet ndërtimi i rrugës hyrëse për në ANP AJ; Më tutje, ndryshimet në marrëveshje duhet të bëhen sipas nevojës;
- Terminali i ri pranohet në përputhje me Marrëveshjen e PPP-së me nivelin e pritur të sigurisë dhe kapaciteteve; dhe
- Komisioni i PPP-së ndërmerr masa në lidhje me punët e mbetura dhe të sqarohet se si do të kryhet dhe të mbikëqyret si dhe të prodhojë një raport për shërbimet Inxhinierit të Pavarur dhe sqarojë shërbimet mbikëqyrëse janë kryer në pajtim me kontratën.

## Shtojca I: Llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga Auditori i Përgjithshëm

(e shkëputur nga ISSAI 200)

### Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë anomali materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për “Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit”.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

### Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale. Auditorët mund të japin tre lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

### Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- Natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë anomali materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë anomali materiale; dhe
- Gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomali, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomalitë, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

#### Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban anomali materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i Theksimit të Çështjes duhet:

- Të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- Të ketë titullin "Theksim i Çështjes" ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- Të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen;
- Të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

## Shtojca II. Opinionet e auditimit dhe mangësitë kryesore menaxheriale

Tabela 1: Llojet e opinionëve

Numri	Llojet e Opinionëve	Numri i opinionëve
1	Opinion pamodifikuar	37
2	Opinion pamodifikuar me theksim të çështjes	46
3	Opinion i kualifikuar	2
4	Opinion i kualifikuar me theksim të çështjes	4
5	Mohim i opinionit	2
<b>Gjithsej</b>		<b>91<sup>38</sup></b>

Tabela 2: Opinionet e pamodifikuara

Organizatat	Buxheti final (000 €)	Mangësitë kryesore menaxheriale
Ministria e Punëve të Brendshme	100.02	Ekzekutimi i lartë i buxhetit në tre mujorin e fundit në kategorinë për investime kapitale; Numri i madh i pozitave të cilat mbulohen me ushtrues detyre si dhe mos kompletimi i të gjithë dokumentacionit para nënshkrimit të kontratës; Pagat e paguara nga kategoria e mallrave dhe shërbimet.
Ministria e Zhvillimit Ekonomik	41.72	Mos zbatim i plotë i rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm; Planifikim jo i mirë i prokurimit; Mangësi në planifikim dhe ekzekutim të buxhetit; Kontrollë jo të mira në procesin e pagesave dhe menaxhimin e subvencioneve; Mos kryerja e auditimit të brendshëm sipas e planin vjetor.
Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës	37.30	Niveli i ultë i ekzekutimit të buxhetit në kategorinë e investimeve kapitale; Vonesa në realizimin e projekteve; Mangësi në menaxhimin e procesit të prokurimit; Mangësi në procesimin e pagesave dhe në mbylljen e avancave.
Ministria e Administrimit Publik	31.31	Mos zbatim i plotë i rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm; Niveli i ultë i ekzekutimit të buxhetit për kategorinë investime kapitale dhe komunali; Vonesa në implementimin e projekteve; Mangësi në menaxhimin e burimeve njerëzore; Mosfunksionim jo i plotë i komitetit të auditimit; Mangësi në menaxhimin e pasurisë jokapitale.
Ministria e Financave (pa përfshirë Doganën dhe ATK)	23.91	Mos zbatim i plotë i rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm; Niveli i ultë i ekzekutimit të buxhetit për kategorinë investime kapitale; Mangësi në menaxhimin e aktiviteteve të prokurimit; Mos mbyllja me kohë e avancave; Regjistrimi i shpenzimeve në kode jo adekuate; Mangësi në menaxhimin e burimeve njerëzore dhe kompensimeve shtesë.

<sup>38</sup> Këtu përfshihen edhe opinionet e auditimit të dhëna për projektet e DANIDA-s dhe TAMAD-it

Këshilli Gjyqësor i Kosovës	19.07	Mos zbatim plotë i rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm; Mangësi në softuerin e të hyrave; Mangësi në menaxhimin e aktiviteteve të prokurimit; Ekzekutimi i pagesave jo në përputhje me rregullat thesarit; Mangësi në menaxhimin e burimeve njerëzore; Mos funksionalizimi i plotë i komitetit të auditimit.
Ministria e Drejtësisë	18.23	Ekzekutimi i ultë i buxhetit në kategorinë e investimeve kapitale; Mangësi në menaxhimin e procesit të prokurimit; Mangësi në raportimin e plotë dhe të saktë të obligimeve; Mangësi në menaxhimin e pasurive në vlerë nën 1000€.
Kuvendi	17.89	Niveli i ultë i ekzekutimit të buxhetit për investime kapitale; Mangësi në menaxhimin e prokurimit; Mos mbështetje e mjaftueshme nga Komiteti i Auditimit për Auditorin e Brendshëm.
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	11.70	Mos zbatim i rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm; Regjistrimi i pagesave në kode ekonomike jo adekuate; Mos pajtueshmëri me LPP; Mangësi në procesimin e pagesave; Mangësi gjatë rekrutimit të burimeve njerëzore; Mos funksionalizim i Komitetit të Auditimit.
Administrata Tatimore e Kosovës	8.01	Niveli i ultë i ekzekutimit të buxhetit në kategorinë investime kapitale; Vonesa në shqyrtimin e rimbursimeve; Mos aplikimi i urdhër-vjeljeve për mbledhjen e borxheve; Mangësi në marrëveshjet e pagesave me këste të obligimeve tatimore; Mos pajtueshmëri me LPP; Pagat e paguara nga kategoritë tjera.
Ministria për Komunitete dhe Kthim	7.37	Mos pajtueshmëri me LPP; Mangësi në menaxhimin e subvencioneve.
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	6.14	Mos zbatim i plotë i rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm; Niveli i ulët i ekzekutimit të buxhetit për investime kapitale; Mangësi në planifikimin e buxhetit; Mangësi në mbikëqyrjen e projekteve kapitale; Mangësi në menaxhimin e pasurive dhe borxheve.
Shtime	5.31	Mangësi në mbledhjen e borxheve të mbetura nga vitet paraprake; Mangësi në menaxhimin e aktiviteteve të prokurimit; Parregullsi në pagesat e punonjësve.
Agjencia Kosovare e Pronës	3.50	Mangësi në planifikimin dhe realizimin e buxhetit; Mangësi gjatë procesimit të pagesave; dhe Mangësi në menaxhimin e burimeve njerëzore.
Zyra e Presidentit	1.88	Mos pajtueshmëri me LPP; Mangësi në procesimin e pagesave, Regjistrimi i shpenzimeve në kode ekonomik jo adekuate; Parregullsi në pagesat e punonjësve.
Ministria e Diasporës	1.72	Planifikimi jo i duhur dhe niveli i ultë i ekzekutimit të buxhetit; Mangësi në menaxhimin e procedurave të prokurimit; shpenzimeve për udhëtime jashtë vendit; dhe subvencioneve.
Ministria e Integritetit Evropian	1.72	Mangësi në menaxhimin e burimeve njerëzore; në raportimin e subvencioneve nga përfituesit për mënyrën e shpenzimit të tyre; dhe në realizimin e pagesave të biletave për persona të cilët nuk ishin të punësuar në Ministri.

Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale	1.68	Mos zbatimi i rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm; Regjistrimi i shpenzimeve në kategorinë ekonomike jo adekuate; Mangësi gjatë lëshimit të licencave; Mungesa e planit dhe komisionit për inspektim e aktiviteteve minerale; Mangësi në procedurat e prokurimit; Menaxhim jo i mirë i të arkëtueshmeve.
Gjykata Kushtetuese e Kosovës	1.56	Mangësi në pagesat për kompensimin e angazhimeve në komisione; Mos pajtueshmëri e rregullores së punës me ligjin e GJKK-së
Ranillug	1.25	Mangësi në menaxhimin e shfrytëzimit të automjeteve dhe mbledhjes së të hyrave vetjake.
Akademia e Shkencave dhe Arteve	1.08	Menaxhimi dhe raportimi jo i mirë i pasurive nën 1000€; Mos pajtueshmëri me LPP; Mbledhja e të hyrave në kundërshtim me rregulloren 03/2010; Mangësi në menaxhimin e burimeve njerëzore.
Avokatit të Popullit	0.91	Mos zbatim i plotë i rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm; Niveli i ultë i ekzekutimit të buxhetit; Shfrytëzimi i ulët i fondeve të donacioneve; Mangësi në menaxhimin e procedurave të prokurimit; Mangësi në procesimin e pagesave.
Autoriteti Rregullativ i Komunikacionit Elektronik dhe Postar	0.85	Mos zbatim i rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm; Niveli i ultë i ekzekutimit të buxhetit për kategorinë e investimeve kapitale; Mangësi në menaxhimin procedurave të prokurimit; Mangësi në procesimin e pagesave; Mangësi në menaxhimin e burimeve njerëzore.
Komisioni i Pavarur I Mediave	0.83	Ndryshimi i nevojshëm i Rregullores për arkëtimin e taksës së licencës për shërbimet mediale audio-vizual; Mangësi në procesimin e pagesave; Numri i të punësuarve në listën e pagave më i lartë se ai në buxhetin vjetor.
DANIDA	0.79	Niveli i ultë i ekzekutimit të buxhetit; Mangësi në menaxhimin e prokurimit dhe shpenzimeve jo përmes prokurimit.
Autoriteti i Aviacionit Civil	0.78	Mbivlerësimi i pasurive nën 1,000€.
Instituti Gjyqësor i Kosovës	0.55	Mangësi gjatë procesimit të pagesave; në menaxhimin e burimeve njerëzore dhe në procesimin e pagesave.
Agjencia Kundër Korrupsionit	0.51	Pagesa e shpenzimeve nga kategoria jo adekuate; Mos pajtueshmëri me LPP; Mangësi gjatë procesimit të pagesave; Pagesat jo në përputhje me rregullat thesarit; Mos pajtueshmëri në mes të regjistrave për pasuritë.
TAMAD	0.47	Mangësi në menaxhimin e aktiviteteve të prokurimit dhe shpenzimeve jo përmes prokurimit.
Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave	0.38	Mos zbatim i plotë i rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm; Mangësi në menaxhimin e pagesave; Menaxhimi i Burimeve Njerëzore, Regjistri i pasurive jo të plotë;
Zyra Rregullative e Hekurudhave	0.35	Pagesa e shpenzimeve duke u bazuar në kontratat e Institucioneve tjera; Mos pajtueshmëri me LPP; Ekzekutimi i pagesave jo në përputhje me rregullat thesarit; Mos mbyllja me kohë e avanceve; Mangësi në menaxhimin e Burimeve Njerëzore.

Zyra e Rregullatorit për Ujësjellës dhe Kanalizim	0.33	Pagesat jo në përputhje me rregullat thesarit; dhe Mangësi në menaxhimin e Burimeve Njerëzore.
Komisioni për Ndihmë Juridike	0.31	Mangësi në menaxhimin e prokurimit.
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa	0.27	Niveli i ultë i ekzekutimit të buxhetit.
Këshilli I Pavarur Mbikëqyrës i SHCK	0.25	Shfrytëzimi i shërbimeve të telefonisë mobile pa kontratë.
Autoriteti Kosovar i Konkurrencës	0.21	Mos zbatim i rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm; Mos pajtueshmëri me LPP; Shfrytëzimi i shërbimeve të telefonisë mobile pa kontratë; Pagesat jo në përputhje me rregullat e thesarit; Mangësi në menaxhimin e automjeteve dhe Burimeve Njerëzore.
Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturor	0.16	Regjistrimi i shpenzimeve në kode joadekuate; Parregullsi në pagesat e Burimeve Njerëzore dhe mos pajtueshmëri me legjislacionin në fuqi;

Tabela 3: Opinionet e pamodifikuara me theksim të çështjes

Organizata	Buxheti final (000€)	Arsyeja për Theksim të Çështjes	Mangësitë kryesore menaxheriale
Gjilan	21.36	Informatat e shpalosura në PVF për pasuritë nuk ishin të plota dhe të sakta; Keq klasifikim i shpenzimeve nga kategoria e investimeve kapitale ishin paguar mallra dhe shërbime dhe subvencione	Mos zbatim i rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm; Mangësi në menaxhimin e prokurimit dhe shpenzimeve jo përmes prokurimit; Mangësi në menaxhimin e të arkëtueshmeve; Hyrja në obligime përtej buxhetit të aprovuar.
Podujevë	17.40	Informatat e shpalosura në PVF për pasuritë nuk ishin të plota dhe të sakta; Keq klasifikimi i shpenzimeve nga kategoria e investimeve kapitale ishin paguar mallra dhe shërbime.	Mos zbatim i plotë i rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm; Puna jo e mjaftueshme nga Njësia e Auditimit të Brendshëm; Mangësi në menaxhimin e prokurimit dhe në arkëtimin e të hyrave.
Vushtrri	13.15	Informatat e shpalosura në PVF për pasuritë nuk ishin të plota dhe të sakta; dhe Keq klasifikim i shpenzimeve nga kategoria e investimeve kapitale ishte paguar mallra dhe shërbime.	Mos zbatim i rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm; Raportimi i dobët tek menaxhmenti i lartë për sa i përket shpenzimeve; Mangësi në arkëtimin e të hyrave.
Malishevë	11.24	Informatat e shpalosura mbi pasuritë dhe pagesat nga palët e treta nuk ishin të plota dhe të sakta.	Mos zbatim i plotë i rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm; Mungesa e vendosjes së një sistemi automatik të faturimit për të hyrat vetjake; Pagesa e shpenzimeve nga kategoria jo adekuate.
Rahovec	10.38	Informatat e shpalosura në PVF për pasuritë nuk ishin të plota dhe të sakta; Keq klasifikim i shpenzimeve nga kodi i kapitaleve ishin bërë pagesa për subvencione dhe për mallra dhe shërbime.	Mos zbatim i plotë i rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm; Mangësi në planifikimin dhe arkëtimin e të hyrave; Klasifikime të pasakta dhe mosrespektim i ligjit me rastin e dhënies së lejeve ndërtimore; Mangësi në menaxhimin e prokurimit.

Drenas	8.10	Informatat e shpalosura në PVF për pasuritë nuk ishin të plota dhe të sakta; Keq klasifikimi i shpenzimeve nga kategoria e investimeve kapitale ishin paguar mallra dhe shërbime.	Mos zbatim i plotë i rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm; Mungesa e mekanizmave për arkëtimin e llogarive të arkëtueshme; Vonesa në realizimin e projekteve; Mos përfshirja e pagave të mësimdhënësive në listën e pagave.
Kamenicë	8.39	Informatat e shpalosura në PVF për pasuritë nuk ishin të plota dhe të sakta; Pagesat e prezantuara si pagesa nga palët e treta ishin financime nga niveli qendror.	Mangësi në menaxhimin e grumbullimit të të hyrave; Prokurim; dhe të llogarive të arkëtueshme; Vonesa në pagimin e borxheve; Mungesa e pavarësisë së Komitetit të Auditimit.
Klinë	8.34	Informatat e shpalosur mbi pasuritë nuk ishin të plota dhe të sakta.	Mos zbatim i rekomandimeve nga Auditorit të Përgjithshëm; Mangësi në menaxhimin e të hyrave; prokurimit; dhe Burimeve Njerëzore.
Fushë Kosovë	7.37	Informatat e shpalosura në PVF për pasuritë nuk ishin të plota dhe të sakta; Keq klasifikim i shpenzimeve nga kategoria e investimeve kapitale ishin paguar mallra dhe shërbime; Stoqet ishin nënvlerësuar.	Dobësi në kontrollet e menaxhmentit të lartë; Mangësi në sistemin automatik të faturimit; Mos pajtueshmëri me LPP; Mangësi në menaxhimin e avanceve për udhëtime zyrtare; dhe llogarive të arkëtueshme; Mos pajtueshmëri me LSHC për kompensimet shtesë të punëtorëve.
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë	6.56	Informatat e shpalosura në PVF për pasuritë nuk ishin të plota dhe të sakta.	Mos zbatim plotë i rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm; Mangësi në realizimin e buxhetit; në menaxhimin e prokurimit; burimeve njerëzore; dhe të hyrave vetanake.
Dragash	6.13	Informatat e shpalosur mbi pasuritë nuk ishin të plota dhe të sakta; Pagesat e prezentuara si pagesa nga palët e treta ishin financime nga niveli qendror.	Mos zbatim i rekomandimeve nga Auditori i Përgjithshëm; Mangësi në qeverisjen e mirë; ekzekutimin e buxhetit; arkëtimin e të hyrave; dhe prokurim.
Obiliq	5.12	Evidencat dhe informatat e shpalosur mbi pasuritë, të arkëtueshmet dhe klasifikimi i shpenzimeve nuk ishin të plota dhe të sakta.	Mos zbatim i plotë i rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm; Niveli i ultë i ekzekutimit të buxhetit në kategorinë e investimeve kapitale; Mangësi në arkëtimin e të hyrave; subvencioneve; Mos themelimi i Komitetit të Auditimit

Shtërpcë	3.57	Informatat e shpalosur mbi pasuritë nuk ishin të plota dhe të sakta.	Mos zbatim i plotë i rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm; Mangësi në arkëtimin e të hyrave; Mangësi në menaxhimin e prokurimit dhe shpenzimeve jo përmes prokurimit.
Novobërd	2.56	Informatat e shpalosur mbi pasuritë nuk ishin të plota dhe të sakta.	Kontrolle jo adekuate për menaxhimin e të arkëtueshmeve; Dhënia e subvencionit në mungesë të vendimit të Kuvendit Komunal.
Hani i Elezit	2.01	Informatat e shpalosura mbi pasuritë dhe pagesat nga palët e treta nuk ishin të plota dhe të sakta.	Mos zbatim i plotë i rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm; Mangësi në arkëtimin e të hyrave.
Klllokot	1.16	Nuk është shpalosur asnjë vlerë mbi pasuritë në PVF-të	Mos zbatim i rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm; Mangësi në arkëtimin e të hyrave; në menaxhimin e prokurimit; dhe Burimeve Njerëzore.
Mamusha	1.13	Informatat e shpalosur mbi pasuritë nuk ishin të plota dhe të sakta; Pagesat e prezentuara si pagesa nga palët e treta ishin financime nga niveli qendror.	Mos implementimi i rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm; inkasimi i të hyrave për buxhetin në nivel jo të kënaqshëm; Mangësi në menaxhimin e prokurimit; dosjeve të Burimeve Njerëzore; Mungesë e politikave të shkruara për subvencione.
Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik	0.34	Trajtimi kontabël i donacionit të pranuar është i gabuar.	Mos implementimi i plotë i rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm; Mangësi në menaxhimin e shpenzimeve jo përmes prokurimit; dhe në prezantimin e pasurive.
Zveçan	1.99	Informatat e shpalosur mbi pasuritë nuk ishin të plota dhe të sakta.	Mangësi në arkëtimin e të hyrave në raport me planifikimin; Mangësi në menaxhimin e subvencioneve; prokurimit, dhe Burimeve Njerëzore; Mos themelimi i Njësisë së Auditimit të Brendshëm dhe Komitetit të Auditimit.
Deçan	6.97	Informatat e shpalosur mbi pasuritë nuk ishin të plota dhe të sakta.	Mangësi në inkasimin e të hyrave për buxhetin; Tejkalimi i limitit të buxhetit për investime kapitale dhe mallra dhe shërbime të cilat janë raportuara si obligime.

Prokurori i Shtetit	5.95	Informatat e shpalosur mbi pasuritë nuk ishin të plota dhe të sakta.	Mos zbatim i plotë i rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm; Mangësi në pagesat për shërbime të ekspertizës në mungesë të dokumenteve relevante.
Kaçanik	5.90	Gjashtë dosje të prokurimit nga viti 2012 janë nën hetim nga prokuroria; Regjistri i pasurive jo i plotë dhe i saktë; Pagesat e prezentuara si pagesa nga palët e treta ishin financime nga niveli qendror.	Mangësi në lidhje me regjistrimin e të hyrave; Mangësi në menaxhimin e prokurimit.
Zyra e Kryeministrit të Kosovës	11.89	Mungesa e raportimit për mënyrën e shpenzimit të subvencioneve.	Mangësi në raportimin e subvencioneve; Mangësi në menaxhimin e shpenzimeve; dhe në regjistrimin e pasurisë. Keq klasifikimi i shpenzimeve;
Dogana e Kosovës	8.88	Mos shpalosja e të arkëtueshmeve të viteve paraprake.	Mungesa e raportimit me kohë e shfrytëzuesve të depove doganore; Mangësi në Evidentimin në Kodet Tarifore dhe Kalkulimin e Akcizës; Kalkulim jo i drejt i Taksës Doganore për mallrat reklamues; Mangësi në gradime të nëpunësve civil dhe ushtrimit të detyrës më gjatë se tre muaj.
Administrata në Mitrovicën Veriore	4.87	Pasuria nuk ishte prezantuar plotësisht.	Mos zbatim i plotë i rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm; Menaxhimi i të hyrave nuk është në nivel të kënaqshëm; Mangësi në menaxhimin e prokurimit; Mungesa e rregullores për dhënieve e subvencioneve .
Prishtinë	85.04	Informatat e shpalosur mbi pasuritë nuk ishin të plota dhe të sakta; Keq klasifikimi i shpenzimeve ku nga kategoria e investimeve kapitale ishin bërë pagesa për mallra dhe shërbime; Obligimet e papaguara nuk janë prezantuar në PVF.	Mos zbatim i rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm; Realizimi i buxhetit në nivel të ultë; Mangësi në menaxhimin e të hyrave; dhe në menaxhimin e prokurimit; Njësia e Auditimit të Brendshëm nuk ofron sigurinë e prituri mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme për menaxhmentin.

Graçanicë	6.78	Informatat e shpalosur mbi pasuritë nuk ishin të plota dhe të sakta; Keq klasifikim i shpenzimeve, ku shpenzimet për mallra dhe shërbime ishin paguar nga kategoria e investimeve kapitale.	Mos zbatim i plotë i rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm dhe Auditimit të Brendshëm, prezantimi jo i plotë i obligimeve; Realizimi i buxhetit në nivel të ultë për Investime kapitale; Dobësi në menaxhimin e subvencioneve; Menaxhimi jo i duhur i llogarive të arkëtueshme; Komiteti i auditimit nuk ishte funksional.
Junik	1.71	Tetë dosje të prokurimit janë nën hetime dhe nuk janë vënë në dispozicion arsyet dhe statusi i këtyre hetimeve; Mungesa e informacioneve për pasurit dhe për pagesat nga palët e treta.	Mungesa e vendosjes së një sistemi automatik të faturimit për të hyrat vetjake; Mangësi në menaxhimin e të hyrave; dhe prokurimit.
Skenderaj	11.70	Informatat e shpalosur mbi pasuritë nuk ishin të plota dhe të sakta; Pagesat e prezantuara si pagesa nga palët e treta ishin financime nga niveli qendror.	Inkasimi i të hyrave për buxhetin ishte në nivel të ultë; Mangësi në menaxhimin e të hyrave; dhe në menaxhimin e prokurimit.
Istog	8.68	Informatat e shpalosur mbi pasuritë nuk ishin të plota dhe të sakta.	Mangësi në planifikimin e të hyrave; procesin e prokurimit; dhe në monitorimin e subvencioneve; Mos regjistrimi i pasurisë, Mos përkushtimi i duhur në realizim të planit të auditimit dhe funksionalizimin e komitetit të auditimit të brendshëm.
Viti	8.61	Mungesa e informacioneve për pasurit dhe për pagesat nga palët e treta.	Mungesa e vendosjes së një sistemi automatik të faturimit për të hyrat vetjake.
Zyra rregullative e energjisë	0.68	Informatat e shpalosur mbi pasuritë nuk ishin të plota dhe të sakta.	Mangësi në ekzekutimin e buxhetit; Realizimi i shpenzimeve pa kontratë; Mangësi në proceset e pagesave; dhe në menaxhimin e Burimeve Njerëzore; Mungesë e regjistrimit E-Pasuria dhe e regjistrimit kontabël.
Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	55.93	Informatat e shpalosur mbi pasuritë, obligimet e papaguara dhe avancet e pambyllura nuk janë të plota dhe të sakta.	Mos harmonizimi i të hyrave; Mangësi në menaxhimin e prokurimit dhe shpenzimeve jo përmes prokurimit; Mangësi në menaxhimin e pagesave për punë jashtë orari; dhe në menaxhimin e subvencioneve.

Universiteti i Prishtinës	29.57	Informatat e shpalosura në lidhje me pasuritë, obligimet e papaguara dhe detyrimet kontigjente janë të pasakta.	Mos zbatim i plotë i rekomandimeve nga Auditorit të Përgjithshëm; Mangësi në inkasimin e të hyrave; Mangësi në menaxhimin e prokurimit; shpenzimeve për pagat; dhe në prezantimin e pasurive, obligimeve dhe detyrimeve kontigjente.
Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sporteve	19.93	Informatat në lidhje me pasuritë janë materialisht të nënvlerësuara dhe transferi i mjeteve në llogaritë bankare të Institucioneve vartëse nuk është i qartësuar.	Mos zbatim i plotë i rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm; Mangësi në planifikimin dhe ekzekutimin e buxhetit; Mangësi në menaxhimin e prokurimit; dhe subvencioneve; Mangësi në sistemin e auditimit të brendshëm.
Ministria e Shëndetësisë	108.94	Informatat e shpalosur mbi pasuritë nuk ishin të plota dhe të sakta.	Mangësi në menaxhimin e subvencioneve; ekzekutim i lartë i buxhetit në fund të vitit; Stoku i lartë i barnave me afat të skaduar; Mos përdorimi efektiv i donacioneve; Mangësi në menaxhimin e pagesave për bordet dhe komisionet e ndryshme.
Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale	229.52	Informatat e shpalosur mbi pasuritë dhe llogaritë e pagueshme është jo i plotë.	Mangësi në menaxhimin e subvencioneve; Klasifikim i gabuar i shpenzimeve; Mos pagesa të pensioneve të personave me aftësi të kufizuar dhe përfituesve të shërbimeve sociale; Mos regjistrimi dhe inventarizimi i pasurisë.
Ministria e Punëve të Jashtme	19.80	Mos aprovimi i shpenzimeve për mallra dhe shërbime të realizuara nga Misionet Diplomatike dhe Konsullore .	Mos zbatimi i plotë i rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm; Mangësi në ekzekutimin e buxhetit; Pagesa për subvencione nga mallrat dhe shërbime; Mangësi në menaxhimin e prokurimit; subvencioneve dhe pasurive; dhe Vonesa në raportimin dhe regjistrimin e të hyrave;
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	23.98	Informatat e shpalosur mbi pasuritë nuk ishin të plota dhe të sakta.	Ekzekutimi i buxhetit në nivel të ulët; Mangësi në menaxhimin e të hyrave vetanake.

Ministria e Infrastrukturës	291.35	Informatat e shpalosur mbi pasuritë nuk ishin të plota dhe të sakta.	Mos zbatim i plotë i rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm; Dobësi në kontrollet e menaxhmentit të lartë; Dobësitë në përmbushjen e kriterëve për licencim të QKT-ve; Mangësi në menaxhimin e prokurimit; Mos pajtueshmëri me LPP.
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	50.14	Informatat e shpalosur mbi pasuritë nuk ishin të plota dhe të sakta; Mos prezantimi i plotë i obligimeve të papaguara në PVF.	Mos zbatim i plotë i rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm; Niveli i ultë ekzekutimit të buxhetit; Raportimi jo i mirë i departamenteve që mbledhin të hyra; Rritja e llogarive të arkëtueshme; Mangësi në menaxhimin e prokurimit; dhe në menaxhimin e Burimeve Njerëzore.
Suharekë	13.65	Informatat e shpalosur mbi pasuritë nuk ishin të plota dhe të sakta; Keq klasifikimi i shpenzimeve, nga kategoria e investimeve kapitale ishin paguar për mallra dhe shërbime dhe për subvencione. Llogaritë e arkëtueshme ishin të mbivlerësuara.	Mos zbatim i plotë i rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm; Pagesat e prezantuara si pagesa nga palët e treta ishin financime nga ministria përkatëse; Planifikim jo i mirë i të hyrave; Mangësi në dhënien e lejeve të ndërtimit në kundërshtim me kërkesat ligjore; Mos pajtueshmëri me LPP; Obligimet e papaguara nuk ishin shpalosur në PVF.
Gjakovë	19.93	Informatat e shpalosur mbi pasuritë nuk ishin të plota dhe të sakta; Keqklasifikimi i shpenzimeve nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve ishin paguar mallra dhe shërbime	Mos implementimi i plotë rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm; Mangësi në menaxhimin e prokurimit, dhe mos pajtueshmëri me LPP; Mos menaxhim i duhur i të hyrave; Mangësi në menaxhimin e burimeve njerëzore; dhe subvencioneve; Moszbatimi i kriterëve për dhënien e bursave; Hyrja në obligime përtej buxhetit të aprovuar.
Ferizaj	22.99	Informatat e shpalosur mbi pasuritë nuk ishin të plota dhe të sakta; Keqklasifikimi i shpenzimeve nga kodi i kapitaleve, janë paguar subvencione dhe mallra dhe shërbime; Paraqitje jo e saktë e vlerës së donacioneve.	Mos zbatim i plotë i rekomandimeve nga Auditorit të Përgjithshëm dhe Auditorit të Brendshëm; Mangësi në planifikimin dhe ekzekutimin e buxhetit; Mangësi në arkëtimin e të hyrave; Mangësi në menaxhimin e prokurimit; pagesat e stafit dhe subvencioneve.

Prizren	35.16	Informatat e shpalosur mbi pasuritë fikse nuk ishin të plota dhe të sakta.	Mos zbatim i plotë i rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm; Menaxhim jo efikas në inkasimin e të hyrave dhe rritje e të arkëtueshme; rritja e obligimeve në fund të vitit; dhe Mangësi në menaxhimin e prokurimit.
Pejë	20.95	Informatat e shpalosur mbi pasuritë fikse nuk ishin të plota dhe të sakta.	Mos zbatim i plotë i rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm; Realizimi i buxhetit në nivel të ultë për investime kapitale; Mangësi në menaxhimin e prokurimit; zbatimin e kontratave; automjeteve; dhe subvencioneve; Mangësi në inkasimin e të hyrave; Hyrja në obligime përtej fondeve.

Tabela 4: Opinionet e kualifikuara

Organizata	Buxheti final (000 €)	Arsyeja për kualifikimin e opinionit	Mangësitë kryesore menaxheriale
Agjencia Kosovare e Privatizimit	7.72	Mos prezantimi në PVF i shpenzimeve profesionale të likuidimit .	Mos zbatim i plotë i rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm dhe Auditimit të Brendshëm; Mungesa e plotë e përbërjes së Bordit të Drejtorëve; Mangësi në ekzekutimin e buxhetit për mallra dhe shërbime; Mangësi në menaxhimin e llogarive të arkëtueshme; kompensimit për anëtarët e bordit. Mungesa e transparencës në vendimmarrjen e Bordit të AKP-së; Mos funksionimi i Komitetit të Auditimit .
Organi Shqyrtues i prokurimit	0.29	Prezantim i gabuar i të hyrave dhe depozitave.	Mangësi në prezantimin e të hyrave dhe depozitave.

**Tabela 5: Opinonet e kualifikuara me theksim të çështjes**

Organizata	Buxheti final (000 €)	Arsyeja për kualifikimin e opinionit	Mangësitë kryesore menaxheriale
Mitrovicë	17.77	Prezantimi i pagesave nga palët e treta nuk ishte i saktë.	Mos zbatim i plotë i rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm; Mangësi në menaxhimin e kontratave; Menaxhimi i dobët i të hyrave nga dhënia me qira e lokaleve, pronës dhe banesave, si dhe Mos zbatimi i rregullores për subvencione.
Lipjan	12.31	Informatat e shpalosur për obligimet dhe pasuritë nuk ishin të sakta; Investimet kapitale ishin të mbivlerësuara; Pagesat nga palët e treta, nuk janë prezantuar drejt.	Mangësi në raportimin e pagesave nga palët e treta; Mos zbatim i rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm; Mangësi në inkasimin e të hyrave; Menaxhimi i dobët i subvencioneve; Keq klasifikim i shpenzimeve; Mangësi në menaxhimin e Burimeve Njerëzore dhe Prokurimit dhe rritja obligimeve të papaguara në fund të vitit;
Partesh	1.04	Pagesa për punëtorë të sektorit të arsimit pa qenë të angazhuar fare në shkolla; Prezantimi i pasurive nuk ishte bërë në PVF.	Mos zbatim i plotë i rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm; Mangësi në menaxhimin e prokurimit; Procesimi i pagesave jo sipas rregullave të thesarit.
Fondi i Privatizimit	0	Mos prezantimi në PVF i shpenzimeve profesionale të likuidimit, këto fonde të shfrytëzuara duhet të mbaheshin në mirëbesim për pronarët dhe kreditorët.	Mangësi në pagesat e shërbimeve për likuidimin e NSh pa aprovim të buxhetit; Mangësi në shpërndarjen e 20% për punëtorët e NSh të privatizuara; Mungesa e përmbljes së kriterëve të kërkuara në procesin e shitjeve të ndërmarrjeve; dhe Mangësi në procesin e monitorimit të ndërmarrjeve të privatizuara përmes metodës së privatizimit me kushte të veçanta.

**Tabela 6: Mohim i opinionit**

Organizata	Buxheti 2013	Arsyeja për mohimin e opinionit	Mangësitë kryesore menaxheriale
Leposaviq	31.04	Kufizime gjatë ekzaminimit të shpenzimeve për paga dhe mëditje.	Prezantimi i informacionit lidhur me pasurinë jo i plotë dhe i saktë; Mangësi në menaxhimin e të hyrave; prokurimit; dhe Kufizime në punë gjatë ekzaminimit të shpenzimeve për paga dhe mëditje.
Zubin Potok	21.02	Nuk janë prezentuar PVF.	

